

**BANKA E SHQIPERISE**

**RAPORTI VJETOR**

**1993**

**Tirane 1994**

## **PERMBAJTJA**

### **KAPITULLI I**

1.Situata ekonomike financiare dhe problemet kryesore te saj	3
2.Inflacioni dhe aktiviteti ekonomik	5
3.Zhvillimi ekonomik gjate vitit 1993	6

### **KAPITULLI II**

1.Zhvillimet monetare para vitit 1993	12
2.Zhvillimet monetare gjate vitit 1993	13
3.Likuiditeti ne ekonomi	19
4.Rezervat e detyrueshme	22

### **KAPITULLI III**

1.Kredia per ekonomine	23
2.Perqindjet e interesit dhe politika e ndjekur per to	26
3.Reforma e sistemit te pagesave	28

### **KAPITULLI IV**

1.Deficiti buxhetor	30
2.Situata e buxhetit te shtetit gjate vitit 1993	31

### **KAPITULLI V**

1.Bilanci i pagesave dhe politika e kurseve te kembimit	35
2. Zhvillimet ne bilancin e pagesave gjate vitit 1993	36
3.Zhvillimet ne rezerven valutore	43
4.Zhvillimet ne tregun e kembimeve valutore	44

### **KAPITULLI VI**

1.Plani financiar i Bankes se Shqiperise	46
2.Reforma per ristrukturimin e Sistemit Bankar	48
2.Marredheniet me institucionet financiare nderkombetare	51
3.Objektivat dhe instrumentat e Politikes Monetare per vitin 1994	51

# KAPITULLI 1

## 1- SITUATA EKONOMIKE FINANCIARE DHE PROBLEMET KRYESORE TE SAJ

Si pasoje e centralizmit ekstremist dhe mbeshtetjes ne vetvete, per dekada te tera Shqiperia u shkeput teresisht nga vendet e tjera te Evropes, madje edhe nga ato te Evropes Qendrore dhe Lindore. Si rrjedhoje Shqiperia u gjend e teresisht e papergatitur per te kaluar ekonomine e tregut, gje qe coi ne shkaterrimin e ekonomise ne pjesen me te madhe te saj dhe ne renien e nivelit te jeteses ne menyre te ndjeshme.

Ne kete situata Shqiperia u perfshi ne nje krize te thelle ekonomike dhe financiare. Vitet 1985-1992 ishin vitet e nje renie te shpejte dhe te theksuar te prodhimit, te zhbilancimeve te medha makroekonomike, te brendshme e te jashtme, te nje crregullimi te pergjithshem ne drejtim dhe ne infrastrukture, te shkaterimit te rezervave valutore si dhe te krijimit te borxhit te jashtem te vendit. Ne vitin 1989 prodhimi i pergjithshem i vendit ishte pergjysmuar, nderkohe qe si prodhimi industrial dhe ai bujqesor pesuan renie te theksuar. Prodhimi i dritherave u ul ne nje te dyten e prodhimit te viteve 1980. Keshtu, Shqiperia nga nje vend eksportues i prodhimeve bujqesore e blegtorale u kthye ne nje vend qe, ne shkalle shume te larte, varej nga ndihmat kritike dhe urgjente nga jashte. Efektet e kesaj situata u pasqyruan menjehere ne treguesit e papunesise te cilet pesuan rritje te ndjeshme vecanerisht ne industri. Si pasoje kjo solli emigrimin e shume shqipetarve, kryesisht ne vendet fqinje.

Ne kete situata ekonomike, gjendja financiare e vendit u keqesua me ritme te shpejta. Kjo u shoqerua me rritje te pages nominale si dhe te pageses ne formen e asistences per ndermarrjet qe nuk funksiononin. Te ardhurat nga taksat rane nga 42 perqind te GDP ne vitin 1990 ne 28 perqind te GDP ne vitin 1991 dhe ende me tej ne 16 perqind ne gjysmen e pare te vitit 1992. Rritja e vazhdueshme e deficitit buxhetor dhe mungesa e nje politike monetare te pershtatshme cuan ne moskontrollin e likuiditeteve, te inflacionit, te kursimeve dhe ne nje nivel thellesisht negativ te perqindjes se interesit, ne terma reale.

Duke reflektuar gjithe keto probleme, mungesen ne furnizim me produkte ushqimore si dhe masat per liberalizimin e cmimeve, gjate vitit 1990-1991, inflacioni u ngrit ndjeshem, ne mbi 100 % duke kaluar rreth 15-20 % ne muaj gjate fillimit te vitit 1992. Ne situaten kur kursi zyrtar i kembimit ishte shume larg nga kursi i kembimit ne tregun paralel, rezervat valutore kishin rene ne menyre te ndjeshme dhe bilanci tregtar ishte keqesuar se tepermi. Bilanci i Pagesave pasqyronte nje deficit te ndjeshem dhe me shume pasoja per ekonomine.

**Tabela 1.1 Treguesit Kryesore Makroekonomike**

	1980-85 1/	1986	1987	1988	1989	1990	1991	1992	1993
Prod. Pergjith. Brendshem 2/	16376	17390	17254	17008	18681	16811	12156	10974	12177
Ndryshimi Real	2.0	5.6	-0.8	-1.4	9.8	-10.0	-27.7	-9.7	11.0

**Ndryshimi ne Perqindje**

Prodhimi Pergjith. Industrial	2.6	5.0	1.5	2.1	5.0	-19.6	-36.9	-60.0	-10.0
Prodhimi Pergjith. Bujqesor	3.0	4.0	0.5	-6.2	10.6	-4.4	-20.9	18.0	14.4
Rritja e Popullsise	2.1	2.0	2.0	2.0	1.9	1.8	-0.9	-1.1	-0.7
Rritja e te Punesuareve	3.0	3.3	3.0	1.7	1.9	0.2	-19.2	-17.4	11.2
Perqindja e Papunesise	4.3	5.4	5.2	6.0	6.7	8.5	11.4	23.9	18.6
CPI 1990=100% 3/	100	100	100	100	100	100	204	687	899
Ndryshimi Vjetor 3/	-0.3	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	104.1	236.6	30.9

**Ne Perqindje ndaj Produktit te Pergjithshem**

Te ardhurat e Buxhetit	50.9	48.7	49.2	53.2	48.2	47.0	32.0	23.3	24.5
Shpenzimet e Buxhetit	53.5	48.8	50.9	54.4	56.8	63.6	64.0	40.7	36.5
Bilanci Fiskal	-2.6	-0.1	-1.7	-1.2	-8.6	-16.6	-34.0	-17.4	-10.3

**Ndryshimi ne Perqindje**

Kreditit i Brendshem Gjithsej	7.5	3.5	12.8	-0.7	21.5	21.9	80.0	59.0	46.4
Paraja Gjithsej	3.5	7.3	7.2	7.8	14.8	21.0	110.0	152.7	73.0
Paraja ne Qarkullim	6.6	7.0	12.3	6.2	0.6	36.5	169.0	123.0	81.8

**Ne miliona USD**

Bilanci i Llogarise Korrente	-27.6	0.5	7.8	-23.5	-70.4	-95.1	-250.0	-31.6	20.6
Bilanci Tregtar	-33.2	-0.6	1.0	-34.8	-90.9	-109.6	-209.0	-453.0	-454.6
Exportet	116.6	95.5	100.3	106.6	132.7	123.0	72.0	70.0	105.3
Importet	149.8	96.1	99.3	141.4	223.6	232.6	281.0	523.0	559.9

1/ Mesatare

2/ Ne milione leke me cmimet e 1990

3/ Fundi i periudhes

## **2- INFLACIONI DHE AKTIVITETI EKONOMIK**


Grafiku i cmimeve gjate 5-vjecarit te fundit para vitit 1990 eshte krejt indiferent, sepse cmimet e brendshme ishin teresisht te izoluara nga ato nderkombetare dhe nuk shprehin koston reale te prodhimit. Cdo diference ndermjet cmimeve fikse me shumice dhe atyre reale paguhej nga buxheti i shtetit duke dhene nje deficit fiskal qe akumulonte inflacion te fshehur i cili shpertheu pas vitit 1991. Pas ketij "stabiliteti", ne nentor te vitit 1991, liberalizohen zyrtarisht disa cmime konsumi. Deri ne gjysmen e pare te 1992 mbetet nen kontroll vetem nje shporte relativisht e vogel produktesh. Ky liberalizim i pjesshem ndikoi ne pershpejtimin e madh te inflacionit ne fillimin te vitit 1992.

Ne dhjetor te vitit 1992 cmimet jane 3.36 here me te larta se ato te dhjetorit te vitit 1991 dhe afro 7 here me te larta se ato te fundit te 1990.

Inflacioni kaq i larte ishte rrjedhoje e nje cbalancimi te konsiderueshem te ofertes dhe kerkeses ne tregun e mallrave te konsumit, si pasoje e nje ritmi rritjeje me te larte te te ardhurave se ritmet e rritjes se prodhimit. Ne fund te 1991 dhe ne fillimet e vitit 1992 kerkesa ne rritje, u shoqerua nga nje ekspansion i papare i mases monetare dhe nga nje deficit i madh buxhetor, dhe duke mos gjetur rruge te lire per tu shkarkuar u perplas ne tregun e brendshem, duke shtuar presionet inflacioniste, qe jo gjithmone u shprehen ne rritje te medha cmimesh (perseri nje sere produktesh ishin te kontrolluara). Kontrolli i cmimeve solli mungesa ne treg dhe rrjedhimisht nje rritje te kursimeve, qe rriti se tepermi gjendjen e parase ne duart e popullsisë.


Mungesat ne treg, deficitin buxhetor, renia e prodhimit dhe kostoja e larte e financimit te tij, asistenca per te papunet ne rritje, perqindjet reale negative te interesit cuan ne kolaps te tregut dhe ne muajin gusht 1992 cuan ne shperthimin e inflacionit te grumbulluar prej muajsh ne nje nivel me te vertete te larte prej 45.7 perqind inflacion mujor. Nje inflacion i tille erdhi si rezultat i heqjes se shtate artikujve nga shporta e mallrave nen kontroll dhe i rritjes se cmimeve per 16 zera te tjere te kontrolluar. Po ashtu edhe ne disa artikuj me cmime te liberalizuar pati ngritje jo te vogel per shkak te rritjes se mesiperme te cmimeve te artikujve te ngjashem. Ne pergjithesi gjate vitit 1992 inflacioni mesatar mujor ka qene 11.1 perqind dhe dispersioni 10.96. Nje shmangie kaq e larte nga mesatarja, vjen vetem nga inflacioni i larte i muajit gusht 1992. Pas muajit gusht vihet re nje renie e inflacionit mujor, qe eshte rezultat i shteses se ofertes, te politikës se shtrenguar te kreditit, por edhe e nje kursi kembimi relativisht te stabilizuar. Furnizimi i bollshem dhe sistematik i tregut me artikuj ushqimore dhe industriale gjate muajve nentor - dhjetor 1992 beri qe inflacioni te arrije piken me te ulet te tij ne dhjetor te 1992 me vetem 1.3 perqind.

### Rritja ne Produktin e Pergjithshem



Grafiku 1.1

### Ndryshimi 12-Mujor i Inflacionit



Grafiku 1.2

### **3- ZHVILLIMI EKONOMIK GJATE VITIT 1993**

Pas perfundimit me sukses te fazes se pare te stabilizimit ekonomik, ne qershor te vitit 1993 Shqiperia hyri ne nje faze te re afatmesme te ruajtjes dhe forcimit te stabilitetit ekonomik e financiar.

Gjate vitit 1993 u bene te gjitha perpjekjet per te hartuar e vene ne zbatim nje sere politikash efektive makroekonomike, te cilat bene te mundur qe treguesit kryesore te inflacionit, te rritjes se prodhimit te pergjithshem dhe permiresimi ne Bilancin e Pagesave te jene ne nivele me te mira se sa ato te parashikuara. Rritja reale e GDP-se per vitin 1993 shenoi nivelin 11 perqind nga 3.7 perqind qe ishte parashikuar. Kontributin kryesor e dha rritja e shpejte e prodhimit bujqesor i cili u rrit rreth 14 perqind si pasoje e masave efektive te marra me pare ne drejtim te liberalizimit te cmimeve dhe privatizimit te tokes bujqesore. Rritje te konsiderueshme gjate kesaj periudhe u vune re ne sektoret e transportit, te ndertimit dhe te sherbimit qe erdhen si rezultat i privatizimit masiv ne keto dege si dhe i shperberjes se sektorit shteteror. Ne te kundert, me rritjen e prodhimit ne sektoret e mesiperme, prodhimi industrial (pjesen me te madhe te te cilit e japin ndermarrjet shteterore) gjate vitit 1993 shenoi renie te metejshme. Kjo erdhi si pasoje e nivelit teknologjik dhe aftesise shume te ulet konkurruese ne shumicen e ndermarrjeve shteterore, te shfaqjes ne to te problemeve te theksuara te likuiditeteve dhe te buxhetit (vetem disa prej tyre moren mbeshtetje nga buxheti i shtetit), nderkohe qe Sistemi Bankar u tregua me i kufizuar ne kreditin bankar per ndermarrjet publike, duke kanalizuar pjesen me te madhe te kredise ne sektorin privat.

Deficiti buxhetor pati ulje ne krahasim me vitin e meparshem. Keshtu ai u ul nga 17 perqind te GDP-se ne fund te 1992 ne 10.4 perqind te GDP-se ne fund te vitit 1993.

Megjithese per shkak te ndryshimit te struktures ekonomike sidomos gjate 6-mujorit te dyte te 1993, buxheti u ballafaqua me veshtiresi ne realizimin e te ardhurave, u arrit te mbahet deficiti i tij ne perqindjen e mesiperme ne fund te 1993 si dhe kerkesat per investim nga burimet e brendshme ne 10 perqind te GDP, nga perkatesisht 18 perqind e GDP dhe 11 perqind e GDP qe ishin parashikuar ne Program. Me qellim te permiresimit te efektivitetit ekonomik dhe uljen e subvencioneve nga buxheti i shtetit, filloi liberalizimi i disa cmimeve te mallrave te shportes qe ne gusht 1992 dhe u pasua nga liberalizimi i cmimit te bukes dhe drithrave ne 1993.

Gjate vitit 1993 investimet e brendshme filluan te marrin fryme dhe te dalin nga kriza e thelle ne te cilen gjendeshin gjate periudhes 1990-1992. Padyshim edhe ne kete fushe kontributin me te madh e dha sektori privat, i cili gjithnje edhe me teper po gjen fusha shtrirjeje.

Keshtu ndersa investimet arriten ne rreth 2 miliarde leke ne vitin 1992, ne vitin 1993 ato arriten ne rreth 5.1 miliarde leke ose 102 perqind e investimeve te parashikuara dhe te gjitha keto investime u perballuan nga burimet e brendshme.


Nese shohim realizimin e investimeve sipas fushave bie ne sy realizimi prej 117 perqind i tyre ne bujqesi, gje qe e tregon vete rritja e madhe e prodhimit bujqesor kete vit. Gjithashtu i ndjeshem ishte realizimi prej 112 perqind i investimeve ne ndertim per strehim, per projekte te infrastruktures, me industri dhe energjitike rreth 95 perqind, ne transport 80 perqind, ne shendetesi 120 perqind etj.

Ndersa ne vitin 1992 patem rreth 10 milione USD investime direkte te huaja , ato ne fund te vitit 1993 ishin te pakten 50 milione USD, si pergjigje e stabilizimit te kushteve financiare dhe te sigurise, per shkak te nje regjimi te hapur kurseesh kembimi dhe tregtie. Te gjitha keto u legalizuan ne nje ligj me liberal te investimeve te huaja te miratuar ne tetor 1993.


Permiresimi i kursimeve publike nga -55 perqind e GDP-se ne fund te vitit 1992 ne -18 perqind te GDP-se ne vitin 1993, rritja me e madhe se sa pritej e kontributit te transfertave nga emigrantet ne Bilancin e Pagesave si dhe rritja, deri diku e te ardhurave per fryme sollen nje permiresim te ndjeshem ne kursimet kombetare per kete periodhe.

Cmimet e shitjes me pakice pavaresisht nga liberalizimet dhe rritjet administrative me nje ndikim prej 10 perqind, u rriten vetem 31 perqind nga rreth 40 perqind rritje e parashikuar. Kjo erdhi si pasoje e nje harmonizimi me te mire ne pergjithesi dhe siguroi stabilitetin e kursit te kembimit.

Gjithashtu, si rezultat i zbatimit te politikave te pershtatshme fiskale dhe monetare kredituese u be e mundur vendosja e kontrollit mbi masen monetare dhe financimin e deficitit buxhetor, gje qe coi ne respektimin e kufijve te parashikuar ne Programin monetar.



Grafiku 1.3



Grafiku 1.4

investuesit etj. te ndikohen me pak nga frika e inflacionit per te ndermarre hapa ne dobi te ekonomise, ne menyre qe kapacitetet e paperdorura deri tani te shfrytezohen. Duhet thene se borxhet e brendshme midis ndermarrjeve dhe deficiti buxhetor kane percaktuar ne kushtet tona ne nje mase mjaft te madhe zhvillimet ekonomike te vitit 1993. Rritja e tyre ne krahasim me zhvillimin ekonomik ka ndikuar jo vetem ne ekonomi, por edhe ne kufijte e perqindjeve te interesit vecanerisht ne ato afatshkurtra.

Kjo gjendje e ndermarrjeve dhe zhvillimit ekonomik ne pergjithesi, domosdo ka influencuar edhe ne treguesit e punesimit. Pas nje renie te theksuar te numrit te punesuarve, periudhen e fundvitit 1991 dhe gjate gjithë vitit 1992, gjate vitit te kaluar u evidentua nje rritje e lehte e numrit te vendeve te reja te punes. Kontributin kryesor ne krijimin e vendeve te reja sigurisht e mban sektori privat, dhe kryesisht sektore te tille ku privatizimi ka ecur me ritme shume te shpejta, si ndertimi, transporti, tregetia, sherbimet etj.

Ne strukturen e punesimit vazhdon te mbizoteroje numri i te punesuarve ne bujqesi, me rreth 55 perqind te totalit, gjithashtu mund te permendim pakesimin e te punesuarve ne sektorin buxhetor me rreth 22 perqind me pak se viti 1992, si dhe rritjen e tyre ne sektorin privat me rreth 32 perqind.

Tani kur shihet qarte tendenca e permiresimit te ekonomise po krijohen nje sere faktoresh pozitive te cilet do te ndikojne ne forcimin e metejshem te stabilitetit te evidentuar ne vitin e kaluar.

Ne kete kornize makroekonomike, deget me te suksesshme gjate vitit te kaluar jane bujqesia dhe ndertimi, qe zene dhe peshen kryesore ne rritjen prej 11 perqind te prodhimit te pergjithshem.

Ne vitin 1993, bujqesia ze 56 perqind te totalit te te ardhurave kombetare, peshe e cila ka ardhur duke u rritur ndjeshem nga viti ne vit. Si rezultat i ndryshimeve tashme te njohura ne lidhje me pronesine mbi token (deri ne fund te dhjetorit 1993 eshte privatizuar 92.5 perqind e tokes bujqesore per t'u ndare), prodhimi i pergjithshem bujqesor u rrit 920 milione leke me shume se ne vitin e meparshem.

Prirja e pergjithshme qe u vu re ne luhatjen e cmimeve dhe ne indeksin e cmimeve te konsumit do te mundesoje qe per nje periudhe afatmesme ekonomia jone te zhvillohet e cliruar nga tensionet inflacioniste te cilat ndikojne ne prodhim. Kjo po ben qe depozituesit,

Tabela 1.2 Indeksi i Cmimeve te Konsumit (viti 1990 = 100%)

	CPI	Ndryshimi Mujor	Ndryshim i Vjetor		CPI	Ndryshimi Mujor	Ndryshim i Vjetor
<b>Janar '92</b>	224	10.0	124.4	<b>Janar '93</b>	734	6.8	226.9
<b>Shkurt</b>	256	14.2	141.7	<b>Shkurt</b>	765	4.3	198.7
<b>Mars</b>	285	11.2	159.1	<b>Mars</b>	772	0.9	170.8
<b>Prill</b>	311	9.0	170.1	<b>Prill</b>	771	-0.1	148.2
<b>Maj</b>	335	7.8	172.2	<b>Maj</b>	767	-0.5	129.1
<b>Qershor</b>	354	5.8	176.6	<b>Qershor</b>	768	0.1	116.9
<b>Korrik</b>	377	6.5	179.3	<b>Korrik</b>	828	7.8	119.7
<b>Gusht</b>	550	45.9	292.2	<b>Gusht</b>	839	1.3	52.5
<b>Shtator</b>	588	6.9	305.5	<b>Shtator</b>	875	4.2	48.7
<b>Tetor</b>	655	11.4	336.9	<b>Tetor</b>	891	1.9	36.0
<b>Nentor</b>	678	3.5	298.8	<b>Nentor</b>	896	0.6	32.2
<b>Dhjetor</b>	687	1.3	236.8	<b>Dhjetor</b>	899	0.3	30.9

Ne strukturen e prodhimit bujqesor mbizoterojne drithrat e bukes, me 47 perqind te te gjithë mbjelljeve te vitit te kaluar si dhe perimet me 36 perqind. Bimet industriale zene vetem 4 perqind. Krahasuar me vitin 1992, kemi rritje prodhimi ne te gjithë llojet e bimeve te arave (kontribut 100 perqind e sektorit privat), ku permendim rritjen e prodhimit te drithrave te bukes prej 57 perqind, rritjen e prodhimit te patateve 28 perqind, te perimeve 3 perqind, etj. Ndersa ne lidhje me bimet industriale kemi nje renie te madhe te prodhimit te panxharsheqerit prej 41 perqind si dhe renien ne perqindje me te vogla te bimeve te tjera si lule dielli, pambuk, soje dhe elb distik.

Fuqizimi me mekanike bujqesore (traktore me goma 6899, me zinxhire 2150, autokombajna 400, etj.) ka cuar ne rritjen e prodhimit bujqesor.

Edhe blegtoria perben nje nga aspektet me spikatese te shnderrimeve ne fshat. Ne baze te statistikave perkatese, gjate tre viteve te fundit, vihët re nje rritje e ndjeshme dhe e vazhdueshme e numrit te krereve te bagetise si dhe e rendimenteve ne blegtoria. Ne prodhimin blegtoral rritje te ndjeshme vihen re ne prodhimin e qumeshtit 29 perqind kundrejt vitit 1990, te vezeve me 2.3 perqind krahasuar me vitin 1992.

Programi ekonomik afatmesem, parashikon nje rritje te prodhimit te pergjithshem bujqesor me ritme relativisht te shpejta, 7-8 perqind cdo vit, ritem i cili eshte 4 here me i larte se ritmi i rritjes se popullsise.

Industria gjate vitit te kaluar perseri shenoi renie ne ritmet e prodhimit si dhe ne peshen qe ajo ze ne totalin e te ardhures kombetare. Keshtu, prodhimi i pergjithshem industrial vleresohet te kete rene 10 perqind dhe pesha e ketij prodhimi ne totalin e te ardhures kombetare eshte vetem 14 perqind, nga 42 perqind ne vitin 1990. Ne dege te vecanta, sipas te dhenave ne natyre qe

disponojme, renie te medha ka ne prodhimin e qymyrgurit me 41 perqind krahasuar me 1992, ne gaz natyror me 20 perqind, ne mineral kromi me 12 perqind dhe ne pleherat kimike me rreth 39 perqind. Disa nga arsyet qe shkaktuan kete renie te prodhimit mund te jene, detyrimet financiare te mbartura qe nga vitet 1991 dhe 1992, bllokimi ekonomik nga mosvjelja e prodhimeve te shitura,

Pergjithesisht, situata ne degen e industrise u karakterizua nga nje gjendje konfuzie ne ndermarrjet e medha te saj dhe dicka me mire ne ndermarrjet e vogla dhe te mesme. Ne shume nga qendrat e medha industriale vazhdon stanjacioni i prodhimit, gjithashtu edhe ai prodhim qe realizohet, per shkak te kostos se larte dhe cilesise me te ulet se te importit, nuk gjen treg shitjeje duke e renduar akoma me shume efektivitetin e ketyre ndermarrjeve. Po punohet intesivisht per ristrukturimin e ndermarrjeve shteterore si nje faktor qe do t'i hape rruge te gjere investimeve te huaja me efektivitet dhe privatizimit si ne industrine e kromit, bakrit, nikelit, drurit, energjise elektrike, ndertimit, cimentos etj.

Ne Transport, si rezultat i procesit te privatizimit, (deri ne fund te vitit '93, jane shitur 80 perqind e objekteve shteterore gjithsej) u zgjerua baza e inventarit te mjeteve duke permiresuar mjaft raportin ndermjet transportit automobilistik dhe atij hekurudhor, ne vecanti per transportin e pasagjereve.

Gjate vitit te kaluar u shtua ndjeshem numri i fluturimeve me jashte shtetit duke arritur mesatarisht 6 fluturime ne dite. Permiresim te ndjeshem pati edhe transporti i pasagjereve me det.

Ne Tregti, privatizimi i lokaleve te tregtimit me pakice dhe te sherbimeve rriti ndjeshem cilesine e sherbimit ndaj popullates dhe permiresoi strukturen e mallrave duke ndikuar pozitivisht ne plotesimin e nevojave te ndryshme.

## KAPITULLI 2

### 1- ZHVILLIMET MONETARE PARA VITIT 1993

Ne ekonomine e centralizuar politika monetare-kredituese luante rol pasiv ne politiken makroekonomike. Vendimet per madhesine dhe shperndarjen e kreditit te nevojshem per realizimin e planit merreshin nga Qeveria. Kredia kryesisht u jepej ndermarrjeve shtetere me perqindje interesi te uleta, duke mos ia pershtatur perqindjen e interesit rrezikut te rikthimit dhe maturimit te kredive te vecanta. Perqindjet e interesit nuk percaktoheshin mbi baze te tregut apo gjendjes se zhvillimeve monetare. Ne kete menyre, ato nuk perbenin nje instrument te rendesishem te zhvillimeve ekonomike te vendit. Kredia, perqindja e interesit dhe kurset e kembimit nuk kishin rol nxites. Ekzistenca e nje kontrolli te drejtperdrejte mbi kreditin dhe detyrimi i arkave te kursimit per te derdhur fondet teprice ne Banken e Shtetit e bente te panevojshem perdorimin e rezervave te detyrueshme si instrument te politikës monetare.

Emetimi i monedhes behej sipas nevojave te Qeverise ne funksion te mbulimit te deficitit buxhetor dhe ndermarrjeve shtetere per pagesa (kryesisht paga e mbulim financiar automatik te humbjeve te tjera ) dhe kerkeses per para te popullsise.

Deri ne vitin 1988 paraja gjithsej rritej mesatarisht 5 perqind ne vit , nderkohe qe rritja vjetore e GDP nominale ishte rreth 1.1 perqind. Per me teper kjo rritje ishte jashte programeve monetare, te cilat ne vetvete nuk ekzistonin. Ndryshimet e parase gjithsej ishin jo te mprehta dhe shkaktoheshin kryesisht nga financimi i buxhetit te shtetit nga ana e Bankes Qendrore. Rritja mesatare vjetore e vogel e Mjeteve Valutore Neto rreth 0.7 perqind tregonin se levizjet ne kete pozicion kishin ndikim te vogel ne zhvillimet monetare deri ne kete vit. Kredia per ekonomine rritej me po ate hap si GDP.

Ne vitin 1989 prodhimi rigjallerohet dhe si rrjedhim i rritjes se kredise se brendshme me 21 perqind nga 0.7 perqind qe ishte ne vitin 1988, paraja gjithsej rritet me rreth 15 perqind. Deficiti i Bilancit te Pagesave keqesoi pozicionin e Mjeteve Valutore Neto.

Ne vitin 1990 kemi nje rritje prej 21 perqind te parase gjithsej, per shkak te financimit te deficitit buxhetor dhe te kredise se pakthyer nga ndermarrjet shtetere. Mjetet Valutore Neto edhe gjate ketij viti vazhdojne e zvogelohen, rezervat valutore ulen, duke mos kryer asnje funksion pozitiv ne zhvillimet monetare.

Prirje te tilla ose te ngjashme shoqeruan edhe vitin 1992 ne zhvillimet monetare. Ai u karakterizua nga nje rritje shume me e shpejte e ofertes se parase ne krahasim me GDP. Kjo rritje e llogaritur nga M2 ishte 253 perqind, kurse rritja reale e GDP ishte 1.9 perqind. Kjo rritje lidhet me nje ekonomi ne caste ringjalljeje modeste dhe ristrukturimi, me lindje dhe zhvillim te sektorit privat , me shpenzime te larta e te ardhura te uleta si dhe me nje deficit

buxhetor relativisht te larte , me kreditim me para ne dore , me rritjen e kredive te pakthjera etj.

## **2- ZHVILLIMET MONETARE GJATE 1993**

Mbi bazen e objektivave te stabilizimit makroekonomik edhe per vitin 1993 Banka e Shqiperise percaktoi objektivat operative te politikes monetare.

Mbi bazen e vleresimeve per uljen e nivelit vjetor te inflacionit ne masen 40 perqind u lejua nje rritje e mases monetare ( M2) prej 44.1perqind ne krahasim me fundin e vitit 1992.

Ne Programin monetar ne baze te detyres per krijimin e rezervave valutore te perdorshme per te mbuluar rreth 10 jave import ne fund te ketij viti u caktua kufiri i poshtem per Mjetet Valutore Neto te Bankes se Shqiperise.ne masen - 462.1milione USD. Sa me sipër u caktua kufiri i sipër i Mjeteve te Brendshme Neto ne masen 90.3 miliardë leke, duke perfshire kredine neto per Qeverine dhe kreditin per ekonomine.

Ne kushtet e mungeses se tregut te zhvilluar te parave dhe te nje Sistemi Bankar modern, politika monetare e Bankes se Shqiperise edhe gjate kesaj periudhe u mbeshtet ne instrumenta direkte kryesisht ne kontrollin e kreditit, rezervat e detyrueshme , likuiditet e detyrueshme etj.


Gjate vitit 1993 zbatimi i politikës monetare ne ekonomi nepermjet Sistemit Bankar ne pergjithesi mund te konsiderohet i suksesshem. Sidoqofte mbajtja e treguesve ne kufijte e percaktuar ne Programin Monetar dhe ruajtja e forcimi i kontrollit monetar ka kaluar ne nje rruge te veshtire dhe me nderlikime te herepashershme. Kjo ka ardhur kryesisht si pasoje e mungeses se sigurimit te nje informacioni cilesor dhe ne kohen e duhur. Nderkohe ulja e shpejte e nivelit te inflacionit dhe vleresimi i metejshe i lekut dhane ndikimet e tyre ne kerkesen per para dhe ne agregatet monetare.

Per periudhen raportuese oferta e parase u rrit 73 perqind nga 44 perqind e parashikuar. Kjo eshte nje zhvendosje paralele dhe pasqyrim i rritjes se paparashikuar te GDP nominale. Ne kete rritje ka ndikuar me rreth 38 perqind paraja ne qarkullim dhe pjesa tjeter i takon rritjes se depozitave.Rritje e parase ne qarkullim ka pasur shume arsye nder te cilat mund te permendin zhvillimin e sektorit privat , kreditimi me para ne dore, veshtersite e theksuara ne sistemin e pagesave, financimi i deficitit buxhetor 100 perqind nga kredia e Bankes se Shqiperise, struktura e kredise, rritja e kredive te pa kthjera ne afat etj.

Tabela 2.1 Gjendja Monetare (ne milione leke)

	Dhjetor '92	Qershor '93	Shtator ' 93	Dhjetor '93
<b>Mj.Val.Neto te BSH</b>	-43240	-44152	-41350	-40151
<b>Mj. Brendshme Neto</b>	30069	31720	36280	44036
<b>Kredia per Qeverine</b>	18531	21497	24410	30974
<b>Kredia per Ekonomine</b>	11539	10224	11870	13057
<b>Te Tjera</b>	41942	51597	49823	45888
<b>Paraja Gjithsej</b>	28771	39165	44753	49773
<b>Paraja ne Qarkullim</b>	9897	12652	14765	17991
<b>Depozitat</b>	18874	26513	29988	31782

Grafiku 2.1 Agregatet Monetare



Edhe depozitat gjate kesaj periudhe kane pesuar nje rritje prej 68 perqind . Ndikimin me te madh ne kete ndryshim ka pasur rritja e depozitave me afat te cilat jane rritur gjate kesaj periudhe me rreth 245 perqind, ndersa ato pa afat vetem 40 perqind. Nuk duhet harruar edhe rritja e depozitave ne valute me 44 perqind. Ne rritjen e depozitave pa afat rreth 96 perqind i takon individeve.

Nga ana tjeter rritja e konsiderueshme e Mjeteve Valutore Neto prej gati 8 perqind ose rreth 3 miliarde leke per te njejten periudhe eshte nje faktor tjeter qe ka ndikuar ne rritjen e mases monetare duke rritur me shume se Programi rezervat valutore si dhe duke zvogeluar detyrimet tona te jashtme.

**Tabela 2.2 Struktura e Depozitave (ne milione leke)**

	Mars '93	Qershor '93	Shtator '93	Dhjetor '93
Depozita pa afat	8171	8767	9868	10242
ndermarrjet	5893	6495	7234	7194
fermat	588	516	943	787
nd.jet e perbashketa	85	46	41	50
sektori privat	471	651	698	1427
individet	1134	1059	952	784
Depozita me afat	6009	8732	9923	11705
ndermarrjet	0	0	0	0
fermat	0	0	0	0
nd.jet e perbashketa	0	18	0	0
sektori privat	57	107	134	171
individet	5951	8608	9788	11534
Depozita ne valute	8884	9014	10197	10248
ndermarrjet	5753	6344	7221	7228
fermat	4	3	53	4
nd.jet e perbashketa	226	437	350	367
sektori privat	305	390	353	761
individet	2596	1840	2220	1888

Nga analiza e treguesve per fundin e vitit shihet se Mjetet Valutore Neto jane 14 perqind me poshte kufirit te Programit; Mjetet e Brendshme Neto ne kufi te tij ; zeri 'Te tjera' e ka tejkaluar ate me 6 perqind dhe 'Paraja gjithsej' po ashtu e ka tejkaluar me 12 perqind (Tabela 2.4).

Ne vazhdim te perpjekjeve per te kaluar drejt ekonomise se tregut, objektivi kryesor i politikës monetare te Bankes se Shqiperise per vitin 1993 ka qene sigurimi i nje rritje jo inflancioniste te GDP-se, e kombinuar kjo me stabilitetin ne Bilancin e Pagesave. Duke i qendruar besnik ketij objektivi, Banka e Shqiperise ka ndjekur nje politike te shtrenguar monetare.

Pika fillestare e programit monetar ka qene vleresimi mbi baze vjetore dhe tremujore i rritjes potenciale reale te ekonomise dhe caktimi i nje niveli te pranueshem te inflacionit. Kjo ka bere qe te percaktohet objektivi per GDP nominale, i cili perben dhe objektivin kryesor per politiken monetare. Pas kesaj Banka e Shqiperise mbi baze te analizave dhe te vleresimeve monetare ne perputhje me objektivat finale ka percaktuar objektivat e ndermjetem monetare te politikës monetare. Oferta e parase eshte vendosur e barabarte me vleresimin per kerkesen per para. Oferta eshte kontrolluar nepermjat vendosjes se kufijve te ekspansionit monetar ( krediti per Qeverine,

kreditit per ekonomine). Ne kete menyre keto instrumenta jane perdorur si objektiva operative te politikës monetare.

**Tabela 2.3 Realizimi i Objektivave te Programit**

TREGUESIT	Dhjetor '92		Dhjetor ' 93	
	Programi	Realizimi	Programi	Realizimi
<b>Mj.Val.Neto te BSH</b>				
(ne milione USD)	-507.4	-428.9	-462.1	-401.5
<b>Mj. Brendshme Neto</b>				
(ne miliarde leke)	82.6	71.6	90.3	89.9
<b>Kredia per Qeverine</b>	20.2	18.4	32.6	30.9
<b>Kredia per Ekonomine</b>	20.8	11.5	14.5	13.0
<b>Te Tjera</b>	41.6	43.7	43.2	45.9
<b>Paraja Gjithsej</b>	31.9	28.7	44.1	48.7

Politika monetare eshte zbatuar nepermjet instrumentave direkte, apo kontrollit te drejteperdrejte te ekspansionit te kreditit te Sistemit Bankar. Per kete qellim jane percaktuar kufijte e kreditit per buxhetin e shtetit dhe per ekonomine.

Duhet thene se bankat tregtare kane respektuar kufijte e kreditit per ekonomine madje per 6- mujorin e pare te vitit 1993 ato kane qene larg kufijve te caktuar. Kjo shpjegohet me keto arsye: Se pari, bankat tregtare nuk ishin te pergatitura per te dhene kredi mbi baza tregtare; se dyti, bankat vinin nga nje e kaluar e hidhur ne drejtim te aktivitetit kreditues dhe me nje portofol kredish te demtuar ne mase nga kredite e keqija; se treti, caktimi i nivelit te interesave mbi baze administrative dhe ne nivele negative ne terma reale nuk i lejonte hapesire bankave per te mbuluar humbjet, te vleresonin kliente dhe projekte te ndryshme mbi baze te rrezikut dhe mbi kete baze te percaktonin perqindjen e interesit.

Sidoqofte, gjate gjashtemujorit te dyte bankat filluan te japin me shume kredi, duke ndikuar ne gjendjen monetare. Kjo gjendje u shoqerua me rritje te ndjeshme ne deficitin buxhetor dhe financimin e tij nga Banka e Shqiperise. Ne muajin shtator kufiri i kredise u thye nga Banka Kombetare Tregtare ne masen 214 milione leke. Kjo u shoqerua me masa te tjera nga Banka e Shqiperise, si shperndarja dhe kontrolli i kufirit te kredise mbi baze mujore, tregtimi i kufirit te kredise etj. Kjo beri qe per vitin 1993 te ruhen kufijte e kreditit te percaktuara ne Programin Monetar.



Tabela 2.4 Kontributi ne perqindje mbi rritjen e Parase Gjithsej

	Qershor '93	Shtator '93	Tetor '93	Nentor '93	Dhjetor '93
<b>Mj.Val.Neto te BSH</b>	-3.1	-9.5	4.6	0.0	-1.8
<b>Mj. Brendshme Neto</b>	3.0	2.4	4.1	3.5	9.1
<b>Kredia per Qeverine</b>	0.3	2.1	2.8	2.7	8.6
<b>Kredia per Ekonomine</b>	2.7	0.4	1.3	0.8	0.5
<b>Te Tjera</b>	7.0	13.6	-5.8	-1.8	-1.1
<b>Paraja Gjithsej</b>	6.8	6.5	2.9	1.7	6.3
<b>Paraja ne Qarkullim</b>	3.3	3.6	0.6	0.9	5.4
<b>Depozitat</b>	3.5	2.9	2.3	0.8	0.8

Kontributi i Mjeteve Valutore Neto, Mjeteve te Brendshme Neto dhe te Tjera Neto ne rritjen e parase gjithsej prej 6.3 perqind ne fundin e vitit 1993 ka qene respektivisht -1.8 perqind, +9.1 perqind dhe -1.1 perqind. Ne muajin maj 1993 Banka e Shqiperise transferoi kredite e keqija nga Mjetet e Brendshme Neto ne Mjetet te Tjera Neto. Kjo solli nje ngritje te menjehershme te kontributit te Mjeteve te Tjera Neto ne rritjen e parase gjithsej si dhe ne ulje te kontributit te Mjeteve te Brendshme Neto. Sikurse u theksua me siper instrumenti kryesor i politikes monetare eshte kontrolli mbi zhvillimin e Mjeteve te Brendshme Neto. Keshtu, per qellime analize kontributi i Mjeteve Valutore Neto dhe Mjeteve te Tjera Neto mund te konsiderohen si faktore te jashtem ne procesin e krijimit te parase. Sic shihet dhe nga grafiku 6 Banka e Shqiperise ka qene relativisht e suksesshme ne harmonizimin e efekteve te faktoreve te jashtem nepermjet ndryshimeve te nevojshme perkatese ne kontributin e Mjeteve te Brendshme Neto ne rritjen e parase gjithsej.

Tabela 2.5 Agregatat Monetare dhe Shpejtesia (ne milione leke)


	Agreg. M1	Agreg. M2	GDP/M1	GDP/M2
31.12.1992	17163	21927	2.9	2.3
31.03.1993	18958	24967	3.5	2.6
30.06.1993	21419	30151	3.8	2.7
30.09.1993	24633	34556	3.9	2.8
31.12.1993	28141	39675	4.0	2.8

Sidoqofte, vecanerisht ne fund te tremujorit te trete 1993, vihet re nje rritje e raportit para ne qarkullim/depozita si dhe nje ngritje e lehte ne shumezuesin e parase. Kjo mund te shpjegohet me nje ulje te rezervave te teperta te bankave


prane Bankes se Shqiperise qe flet per nje shtrengim te metejshem te likuiditetit te bankave.

Edhe pse, per arsyet qe permendem oferta e parase eshte rritur me shpejt se sa ajo e parashikuar ne programin monetar, niveli i inflacionit ka ardhur duke u ulur me shpejt se parashikimi. Kjo mund te shpjegohet me faktin se rritja e parase u shoqerua me nje kerkese me te madhe cka konfirmohet nga rritja e raportit para/depozita. Faktoret qe kane cuar ne rritjen e transakcioneve dhe kerkeses mund te jene: ulja e nivelit te interesave, ulja e nivelit te inflacionit etj. Ne kete menyre, rritja ne oferten e parase mbi ate te parashikuar nuk ka qene me pasoja inflacioniste gjate periudhes qe analizojme. Sidoqofte, rritje te tilla mund te behen burim shperthimi monetar dhe inflacioni ne periudha afatmesme.

Grafiku 2.4 Ndryshimi mujor i Agregateve Monetare



Grafiku 2.5 Shpejtesia e qarkullimit te parase



Problemi i likuiditeteve ne ekonomi lidhet kryesisht me krijimin e likuiditeteve te teperta qe kane ardhur nga dhenia e kredive ne cash, kryerja e transaksioneve me para ne dore jo vetem ne tregun privat por edhe ne ate shtetror si dhe ne nje mase te madhe nga deficitit buxhetor. Te gjitha keto cuan ne rritjen e emisionit dhe realisht ne nje zhvleresim te monedhes kombetare deri ne vitin 1992. Keto dhe faktore te tjere krijuan nje strukture jo te pershtatshme depozitash, sollen bllokim te plote te pagesave ndermjet ndermarrjeve, rritje te madhe te financimeve me para ne dore te shpenzimeve te buxhetit, shtim te kredive te pakthyera ne afat etj. qe cuan ne portofole jo likuide te bankave. Po keshtu per shkak te rritjes se pozicioneve ne valute te bankave te nivelit te dyte per nje kohe te gjate ato edhe gjate vitit 1993 paten probleme te likuiditeteve. Ato i zgjidhen keto probleme duke kerkuar rfinansim nga Banka e Shqiperise. Sigurisht Bankes se Shqiperise iu desh ne keto raste te shtojte emisionin e saj , duke mbajtur edhe pasojat e nje veprimi te tille. .

Banka e Shqiperise ka vendosur kufizime te cilat sherbejne per te penguar cdo rritje te pakontrolluar dhe te paargumentuar te rezervave valutore te bankave tregtare dhe ka ushtruar dhe ushtron presion per nje administrim sa me efektiv te tyre. Kjo do t'i sherbeje nje kontrolli me efektiv mbi masen monetare dhe parandalimit te keqesimit te metejshem te gjendjes se likuiditeteve ne Sistemin Bankar.

Deri tani , politika monetare e ndjekur nga Banka e Shqiperise ka qene relativisht efektive, duke arritur objektivat e caktuar. Sidoqofte, nje problem po del gjithnje e me shume ne procesin e zbatimit te politikes monetare dhe te kontrollit monetar. Skema e ndjekur nuk i ka kushtuar kujdesin e duhur kalimit drejt instrumentave indirekte te politikes monetare, per me teper kur nuk ka nje kufi te prere te kalimit nga instrumentat direkte ne ato indirekte. Banka e Shqiperise ne politiken e saj monetare eshte perqendruar me pak ne ecurine , analizen dhe kontrollin e bazes monetare dhe te rezervave te teperta te bankave te nivelit te dyte prane Bankes se Shqiperise. Ne qofte se rritja e bazes monetare eshte e jashtme dhe e pakufizuar , kjo do te sjelle , edhe ne rastin e perdorimit me efektivitet te kufijve te kreditit nje ulje te shumezuesit te parase dhe akumulim te rezervave te teperta. Ne fakt, kjo eshte ajo qe ka ndodhur gjate kesaj periudhe dhe ne Shqiperi. Ne kushtet e mungeses se instrumentave per t iu pergjigjur kesaj suate , akumulimi i rezervave te teperta do te krijoje presion mbi kufijte e kreditit te vendosur. Ne rastin me te keq, ky akumulim mund t'i hape rruge krijimit te nje tregu te pakontrolluar krediti jashte sistemit bankar apo humbjes se kontrollit mbi zhvillimet monetare. Ne periudha afatmesme , kjo do te krijoje veshtersi per te kaluar nga instrumenta direkte ne instrumenta indirekte te politikes monetare. Per kete arsye, Banka e Shqiperise po perqendrohet ne krijimin e nje sistemi monitorues dhe drejtues te likuiditeteve , per te kontrolluar dhe sistemuar rezervat e teperta te bankave dhe bazen monetare. Kjo do te realizohet nepermjet caktimit te objektiveve operative te ndermjetme tremujore dhe mujore per rezervat e teperta te bankave dhe financimin e deficitit te buxhetit nepermjet Bonove te Thesarit nga sektori privat, objektiva keto qe jane ne perputhje te plote me objektivat kryesore te politikes monetare.

Mbi bazen e analizës se bërë del se ekziston një korrelacion i ngushtë ndërmjet rritjes së agregatit monetar (M3) dhe GDP nominale. Nga ana tjetër analiza për shpejtesinë e qarkullimit të parës na siguron informacionin e nevojshëm për stabilitetin e raportit të agregatit monetar ndaj GDP nominale. Shpejtesia e qarkullimit ka lëvizur në kufijte ndërmjet 1.7 dhe 2.8 duke krijuar një drejtim me prirje ngritjeje. Kjo prirje mund t'i atribuohet një politike monetare të shtrenguar.


Deri në tremujorin e dytë të vitit të vitit 1992 kemi pasur një përputhje të ndryshimeve në agregatin monetar (M3) dhe kreditin e brendshëm në total. Me pas kur rritja e ekspansionit të kreditit të brendshëm u bë një objektivi operativ dhe stabil, kjo lidhje u dobësua gradualisht. Me pas rena e ndjeshme, me vonë e këtij korrelacioni shpjegohet me politiken suksesshme të Bankës së Shqipërisë për të stabilizuar rritjen e (M3) nëpërmjet përdorimit të kontrollit mbi Mjetet e Brendshme Neto.

Gjithashtu nga analiza e ecurisë së likuiditetit në ekonomi dhe rezervave të tepërta të depozituara në Bankën e Shqipërisë shihet se ekziston një korrelacion i lartë ndërmjet ritmit të rritjes së rezervave të tepërta dhe bazës monetare (0.86) ashtu sikundër ekziston ky korrelacion edhe ndërmjet ndryshimit në kredinë e Bankës së Shqipërisë për Qeverinë dhe rezervave të tepërta (0.76).

Kontributi i rezervave të tepërta në ritmet e rritjes së bazës monetare është i lartë. Kjo do të thotë se nëpërmjet kontrollit mbi zhvillimet e rezervave të tepërta ekziston mundësia potenciale e kontrollit edhe mbi zhvillimet në masën monetare. Nëpërmjet përdorimit të kufijve të kreditit, lidhja ndërmjet bazës monetare dhe (M3) është e dobët (0.20). Kjo sepse shumezuesi i parës do të ishte relativisht i vogël. Ky është një fakt ku shumezuesi i parës ka ardhur gjithnjë duke u ulur.

Në qoftë se llogariten këto tregues ku nga baza monetare janë hequr rezervat e tepërta, atëherë koeficienti i korrelacionit do të ngrihej në nivelin (0.57) dhe shumezuesi i parës do të stabilizohej në nivelin rreth 2.5.

Kujdes po i kushtohet ndryshimeve në total të likuiditetit, në mënyrë që zbutja e pozicioneve të përgjithshme të likuiditetit në Sistemin Bankar të rrisë aftësinë e tij për të dhënë kredi, po ashtu për të shmangur disekuilibret në treg dhe presionet mbi përqindjet e interesave të tregut që shkaktojnë ato. Tani po behen përpjekje për të kontrolluar likuiditetet në treg duke ndërhyrë në tregun e parës.




Grafiku 2.6

#### **4- REZERVA E DETYRUESHME**

Ndryshimi qe pesoi llogaritja e rezerves se detyrueshme, ne fillim te vitit 1993, i lejonte bankat e nivelit te dyte te perdornin me me efikasitet fondet e tyre gjate periudhes dhe ju krijonte mundesi per te ndjekur nivelin e rezervave te detyrueshme gjate muajit te mbajtjes se tyre. Ne rast te mosndjekjes bankat rendoheshin me interesa te larta per masen e mosplotesimit te saj.

Perdorimi i ketij sistemi gjate vitit 1993, u bazua ne te dhenat e bilanceve kontabel dhe valutore te bankave te nivelit te dyte. Per vonesa ne hartimin e ketyre bilanceve dhe ndjekjen e rezerves se detyrueshme u vune re mosplotesime ne kohe qe e detyruan Banken e Shqiperise te pergatise per vitin 1994, nje model me efektiv llogaritjeje. Ky model u bazua ne iniciativen e plotesimit te rezerves se detyrueshme dhe ne gjobat e aplikuar per mosplotesimin e saj.

Plotesimi i rezerves se detyrueshme paraqitet ne grafikun e meposhtem:



Grafiku 2.7

# KAPITULLI 3

## 1- KREDIA PËR EKONOMINE

Edhe gjate vitit 1993 Sistemi Bankar mbeshteti zhvillimin ekonomik me ane te kredive nga Sistemi Bankar. Ne baze te Programit Monetar kjo kredi ishte parashikuar ne masen 14.5 miliarde leke. Ne fund te vitit ajo arriti shifren prej 13 miliarde leke. Krahasuar me fundin e 1992 ajo pati nje rritje prej 13 perqind. Per shkak te nje deficiti me te larte buxhetor ne 6-mujorin e dyte kredia per ekonomine perben 12 perqind te shteses se Mjeteve te Brendshme Neto, nderkohe qe kredia per Qeverine perben 88 perqind te kesaj shtese. Gjate vitit 1993 bankave iu shperndane si kufi 7.4 miliarde leke. Realizimi i kufirit te kredise ishte 39.4perqind.

Gjate vitit 1993 jane akorduar 10.3 miliarde leke. Nga kjo sektorit privat iu dha me shume kredi rreth 54.4 perqind duke patur nje rritje prej 3.6 here ne krahasim me nje vit me pare. Banka Tregtare Agrare ka masen me te madhe te kredise ne kete sektor me 27 perqind te totalit te perdorimeve. Politika e ndjekur ne kreditimin e ketij sektori dha rezultate pozitive sepse burimi kryesor i rritjes se prodhimit gjate 1993 ishte sektori bujqesor ku prodhimi iu pergjigj mire liberalizimit te cmimeve dhe privatizimit te tokes bujqesore. Kredia afatshkurter ne sektorin privat ndihmoi ne privatizimin pothuajse teresor te njesive te tregtimit, hapjen e shume njesive te reja, per investime te vogla prodhuese, per shperberjen e sektorit shteteror te ndertimit, import lendesh te para etj. Sektori shteteror gjate kesaj kohe u mbeshtet me 4.8 miliarde leke kredi dhe Banka Kombetare Tregtare me 36 perqind te totalit te perdorimeve ishte banka me masen me te madhe te kredise se dhene per kete sektor.

74 perqind e kredise se dhene nga sistemi bankar e ze kredia afatshkurter. Banka Kombetare Tregtare ka dhene me se shumti kredi afatshkurter qe ze 37 perqind te totalit te perdorimeve. Kredia afatshkurter per sektorin shteteror eshte dhene per sektore jetike si ndermarrjet e naftes, te bakrit, te energjitikes etj. Kredia afatgjate eshte dhene kryesisht per blerje mekanike bujqesore, per privatizimin e ndermarrjeve te mesme e te vogla, Entit Kombetar te Banesave etj.

Perdorimi i kredive gjate vitit 1993 perben 9.2 perqind te prodhimit te pergjithshem bruto (GDP) vjetor.

Sistemi Bankar ne vitin 1993 ka arketuar 7.4 miliarde leke nga kredite e dhena.Me shume kredi jane arketuar nga Banka Kombetare ne masen 67.3 perqind te totalit te shlyerjeve. Per kete banke shlyerjet jane sa 93.4 perqind e perdorimeve per vitin ne shqyrtim.

Me poshte jepet struktura e perdorimit dhe shlyerjes te kredise sipas bankave, afateve te maturimit dhe sektoreve:

Tabela 3.1 Perdorimi dhe Shlyerja e Kredise sipas bankave


	Perdorimi	Shlyerja
<b>Banka Kombetare Tregtare</b>	<b>51.0</b>	<b>62.3</b>
Sektori shteteror	81.7	80.6
Sektori privat	18.3	19.4
Kredi Afatshkurter	82.4	87.4
Kredi Afatgjate	17.6	12.6
<b>Banka Tregtare Agrare</b>	<b>34.8</b>	<b>30.0</b>
Sektori shteteror	22.5	47.2
Sektori privat	77.5	52.8
Kredi Afatshkurter	86.4	90.7
Kredi Afatgjate	13.6	9.3
<b>Banka Kursimeve</b>	<b>13.5</b>	<b>7.7</b>
Sektori shteteror	23.0	0.7
Sektori privat	77.0	99.3
Kredi Afatshkurter	54.7	91.7
Kredi Afatgjate	45.3	8.3

Nje pasqyrim te stokut te kredise per ekonomine sipas sektoreve e jep grafiku 3.1.

Ne fund te vitit 1993 kredia e pakthyer ne afat per te gjithë Sistemin Bankar arriti ne 933 milione leke ose ne 13.6 perqind te gjendjes se kredive ne kete kohe. Sipas bankave kjo ndahet ne:

Banken Tregtare Agrare	86.5% kredi afatshkurter
	83.7% sektori privat
Banka Kombetare Tregtare	96.0% kredi afatshkurter
	62.6% sektori privat
Banka e Kursimeve	100% kredi afatshkurter
	100% sektori privat

Stoku i Kredise per Ekonomine sipas sektoreve (ne mln leke)



Grafiku 3.1

Me gjithë përpjekjet për vjeljen e detyrimeve nga debitore të ndryshëm edhe gjatë këtij viti nuk u arrit të ndalej rritja e masës së kredive të pakthyera në afat, kjo sidomos për sektorin privat dhe për kredinë afatshkurter. Arsye të një gjendjeje të tillë duhen kërkuar në dhenien e kredive të pastuduara mirë, në motivimin e bankave për të kredituar kliente të shëndoshe financiarisht, dhënia e kredive me afate të papershtatshme etj. Kjo gjendje ka krijuar, krahas faktorëve të tjerë, probleme likuiditeti në bankat e nivelit të dytë e deri në rifinancim nga Banka e Shqipërisë të këtyre bankave.

Problemi i politikës kredituese është shqyrtuar i lidhur ngushtë me fatin e depozitave. Kjo arsye ka udhëhequr Bankën e Shqipërisë në përcaktimin e kufirit të kredive, në zbatimin e politikës së shtrenguar të rifinancimit etj., për të ulur përqindjen e kredive të pakthyera në afat.

Në përgjithësi duke parë përqindjen e kredive të pakthyer në afat, do të nxirrnim si konkluzion kryesor se bankat e nivelit të dytë akoma nuk po arrijnë të përqendrohen siç duhet në 4 fazat e rëndësishme të akordimit të një kredie, respektimi i të cilave ka të bëjë me garantimin e kredive dhe me minimizimin e rrezikut për bankën. Me konkretisht bankat shqiptare ende nuk janë familjarizuar me shqyrtimin e hollësisht të:

1. Qellimit të dhenies së kredive;

2. Burimet e kthimit të kredive;

-burimet primare (ndryshimi në gjendjen e likuiditeteve, procesi i prodhimit etj.)

-burimet sekondare (rifinancimi apo shtyrja e kredive, shitja e një pjese të kapitalit themelor)

3. Hartimi i planit të kthimit të kredive në kohë;

#### 4. Disiplinimi i kthimit te kredise ne kohe.

Perpara dhe gjate kalimit neper keto faza eshte e nevojshme te kryhen analiza ekonomike financiare, te ekonomise ne pergjithesi dhe te sektoreve dhe klienteve ne vecanti. Nepermjet ketyre analizave, bankave do t'u krijohet mundesia te gjejne kliente me te pershtatshem, te rrisin te ardhurat dhe te ulin rrezikun.

## **2- PERQINDJET E INTERESIT DHE POLITIKA E NDJEKUR**

Fillimi i Reformes Ekonomike ne 6-mujorin e dyte 1992, u shoqerua me nje rritje te konsiderueshme te perqindjeve te interesit, perqindjet reale te te cilit, si pasoje inflacionit shume te larte qe shoqeroi periudhen pas vitit 1990 ishte shnderruar ne perqindje thellesisht negative. Ne keto kushte Banka e Shqiperise ngriti perqindjen e interesit baze, si dhe gjithë interesat e tjere me objektiv kryesor arritjen e perqindjeve reale pozitive te interesit ne fund te 6-mujorit te pare te vitit 1993, nepermjet uljes se programuar te nivelit te inflacionit. U njoftua interesi prej 40 perqind me baze vjetore per rifinancimin, te shoqeruar kjo edhe nga nje shkallezim i interesit per shuma mbi nje limit te caktuar. Mbi kete baze u be detajimi ne periudha te ndryshme kohe i interesave . Per te stimuluar bankat e nivelit te dyte per te marre pjese ne treg dhe per te qene sa me fleksibel ne mbulimin e kostos se tyre, interesi per depozitat u la si kufi i poshtem i detyrueshem per tu zbatuar, kurse interesi per kredine u hoq si kufi i siperm dhe u la i lire. Ne kete menyre niveli i interesave filloi te luaje nje rol te rendesishem ne zhvillimet ekonomike e monetare.

Si rezultat i kontrollit te inflacionit (niveli i tij ra nga 6.8 perqind ne fund te janarit 1993 ne 0.1 perqind ne fund te qershorit 1993 d.m.th. me shume se c'pritej), te stabilitetit te kursit te kembimit, u be e mundur te kalohej ne nivele pozitive te interesit ne terma reale. Duke pasur qellim stimulimin e zhvillimit ekonomik dhe duke ruajtur nivelet pozitive ne muajin qershor te vitit te kaluar u be ulja e perqindjeve te interesit. Per bankat tregtare perqindjet ishin orientuese. Perqindjet e interesit per dhenie kredie u perfshine ne kufijte nga 20 perqind per kredite me maturim tremujor ne 30 perqind per kredite me maturim vjetor , nderkohe qe depozitat me afat u perfshine respektivisht ne kufirin nga 14 perqind ne 25 perqind. Padyshim kjo do t'i jepte frymemarrje aktivitetit te kreditimit e rritjes se prodhimit.

Ne ecurine e metejshme te vitit te kaluar u vu re nje ndryshim i ndjeshem ne strukturen e depozitave, ku ato me afat fituan prioritetin nga 25 perqind ne fund te vitit 1992 ne 36 perqind ne fund te vitit 1993, fenomen i cili ne kushtet e ekzistences se kufirit te kreditit rriti shume koston e bankave; nje perqindje mujore inflacioni shume e ulet ne muajt e fundit te vitit 1993, qe beri te mundur thellimin e nivelit pozitiv te perqindjeve reale te interesit; stabiliteti i lekut shqipetar kundrejt monedhave te huaja gjate gjithë vitit si dhe prirja e pergjithshme nga te gjithë kursimtare e vegjel per te depozituar parane e tyre ne banke, duke injoruar cdo lloj alternative tjeter investimi, krijuan kushtet qe ne ne fillimin e vitit 1994 (17 Janar 1994) perqindjet e interesit te ulen perseri dhe me konkretisht ato paraqiten ne tabelen 3.2.



Tabela 3.2 Perqindjet e Interesit

Perqindjet reale 1/


	01.07.92	01.06.93	17.01.94	1993	Kredi	Depozita
Perqindja e Rifinancimit						
Perqindja Baze	40	34	32	Janar	-1.3	-6.3
Tranci i Dyte	45	39	37	Shkurt	7	1.6
Tranci i Trete	50	44	42	Mars	9.4	3.9
				Prill	22.6	16.4
Perqindjet e Depozitave 2/				Maj	30.6	24.0
12-M	32	25	22	Qershor	15.4	11.1
6-M	25	19	16			
3-M	18	14	10			
Depozita pa Afat	3	3	3	Korrik	10.8	6.6
				Gusht	8.5	4.4
Perqindjet e Kredise				Shtator	8.1	4.0
12-M	39	30	26	Tetor	6.9	2.9
6-M	32	26	22	Nendor	6.2	2.1
3-M	25	20	17	Dhjetor	14.4	10.1

1/ Per kredi dhe depozita me maturim 1 vit

2/ Perqindje DysHEME te vendosura nga BoA

Ne kushtet e deritanishme te ecurise se reformes financiare ne Shqiperi, perqindja e interesit (ajo per refinancim dhe niveli dysHEME per depozitat) percaktohet me vendim te Bankes se Shqiperise, kjo e diktuar dhe nga mungesa e nje tregu te mirefillte te letrave me vlere dhe te kapitaleve, gje qe do te conte ne nje percaktim te lire te perqindjeve te interesit, ne baze te kerkeses dhe ofertes. Mbi kete baze do te behej e mundur qe dhe perqindja baze e interesit, si nje instrument ne duart e bankes qendrore, ta luante me mire rolin e saj ne ekonomi. Per kete qellim, ne menyre qe bankat e reja private ta ndiejne veten sa me te lire per te konkurruar midis tyre, me vendim te Bankes se Shqiperise ato nuk jane subjekt i rregullimeve administrative te perqindjeve te interesit per kredite dhe depozitat. Bankat private jane te lira te percaktojne perqindjet e tyre te interesit, bazuar ne kushtet e tregut. Ky vendim lejon qe bankat private te perfitojne nga interesa neto te favorshme, por i konsideron ato pergjegjese te paguajne interesat e depozitave dhe detyrimeve te tjera sikurse percaktohet ne treg.

Perqindja reale e Interesit per kredi dhe depozita  
me afat maturimi 1-vit



Grafiku 3.2

### **3- REFORMA NË SISTEMIN E PAGESAVE**

Ne fund te vitit 1991 si dhe gjate vitit 1992, u vu re fenomeni i grumbullimit dhe rritjes se panderprere te detyrimeve midis ndermarrjeve, e cila solli fryrjen e portofoleve ne banke ne menyre te konsiderueshme duke nxjerre ne pah paafesine e sistemit ekzistues te pagesave. Kjo rritje e shpejte e pagesave te prapambetura perben nje problem serioz per ekonomine ne kushtet e kalimit ne ekonomine e tregut. Marredheniet e debi kredive ne sektore te ndryshem kane shkaktuar konsekuenca te renda, duke sjelle ndikime negative ne kontrollin monetar, duke paralizuar apo sjelle falimentimin e mundshem te sistemit te pagesave si dhe duke ndikuar negativisht ne politiken e kreditit dhe nivelin e inflacionit.

Nje nga hapat e pare dhe vendimtare qe mori Banka e Shqiperise ne kontrollin e detyrimeve te ndersjella ishte fillimi i reformes ne sistemin e pagesave. Me konkretisht u synua ne:

Urdhrat per pagesa (urdherxhirimet) dhe ceqet e leshuara nga ndermarrjet do te pranohen nga banka vetem nese ka fonde te mjaftueshme ne llogarine e ndermarrjes per te kryer pagesen.

Ne rast se nje ndermarrje, firme apo person privat paraqiste ne banke nje urdher pagese (urdherxhirim), apo cek per te cilin nuk kishte fonde te mjaftueshme ne llogari, banka ia kthente ndermarrjes, firmes apo personit privat urdherpagesen (urdherxhirimin), kerkese-arketimin apo cekun.

Kjo reforme u thellua me tej gjate vitit 1993, ku perfundoi projekti i plote mbi futjen e cekut dhe "clearing house" ne sistemin e pagesave. Ky projekt

parashikon krijimin e nje sistemi efektiv zhvendosje dhe shperndarje te domosdoshem per levizjen efektive te mallrave ne treg, nje sistem pagesash te domosdoshem per transferimin efektiv te vleres. Hartimi dhe venia ne jete e sistemit te cekut si nje instrument ku ekziston besimi publik kerkon nder te tjera te rrise besimin ne integritetin e te gjithe sistemit te pagesave.

Per nje kohe relativisht te shkurter Banka e Shqiperise ka bere nje progres te dukshem duke percaktuar te gjitha rregullat dhe procedurat e "clearing house" shtypjen e ceqeve etj. Banka e Shqiperise ka kryer kurse trainimi me specialiste nga i gjithe Sistemi Bankar.

## KAPITULLI 4

### 1- DEFICITI BUXHETOR PARA VITIT 1993

—

Deri ne vitet '90 funksioni kryesor i buxhetit te shtetit ishte rregullimi i objektivave te planit te centralizuar (vecanerisht financimi automatik i shpenzimeve per investime te caktuara ne plan dhe mbulimi financiar i humbjeve te planifikuara ose jo te ndermarrjeve). Po ashtu buxheti ishte mjeti kryesor per shperndarjen e burimeve dhe i stabilitetit makroekonomik ne mungese te cmimeve te lira , te politikës monetare dhe te tregjeve te kapitalit, per te balancuar kerkesen dhe oferten e burimeve ne dispozicion.

Ne fund te kesaj periudhe, shpenzimet e pergjithshme te qeverise llogariteshin rreth 60 perqind te GDP.

Deri ne vitin 1992 kerkohej qe buxheti zyrtar te ishte me suficit. Deri ne fundin e viteve '70 kjo realizohej duke regjistruar kredite e huaja si te ardhura per buxhetin e shtetit. Me nderprerjen e kredive te huaja, Qeveria i konsideronte te ardhura huate qe merrte nga Banka Qendrore (ose terheqjet nga depozitat ne banke). Buxheti ne tremujorin e pare te 1992 ishte per here te pare me deficit te deklaruar zyrtar.

Deri ne 1990 te ardhurat e buxhetit realizoheshin kryesisht nga taksat qe zinin rreth 70 perqind te te ardhurave te pergjithshme. Ne anen e shpenzimeve subvencionimet ishin zeri individual me i madh.

Gjate vitit 1991 deficiti i buxhetit u rrit per shkak te pageses se punetorve te papune me 80 perqind te pages se tyre si edhe te renies se fitimeve te ndermarrjeve. Edhe gjate 1992 te ardhurat rane mjaft dhe ndersa prodhimi filloi te ndryshoje nga sektori shteterore ne ate privat, mbledhja e taksave u be gjithnje e me e veshtire.

Te ardhurat nga taksat rane ne 16 perqind e GDP. Gjate gjysmes se dyte te vitit 1992 u kalua ne nje buxhet te shtrenguar qe dha si rezultat mbylljen e vitit 1992 me nje deficit te buxhetit te shtetit sa 17.4 perqind e GDP. Permireshimi u mbeshtet ne burimet e reja te te ardhurave, duke perfshire edhe taksat doganore

### 2- SITUATA NË VITIN 1993


Viti 1993 ishte viti i hopit cilesor ne politiken fiskale e cila coi ne realizimin e treguesve te buxhetit te shtetit ne perputhje me Programin afatmesem te zhvillimit te ekonomise . Keshtu, u mbajt nen kontroll te vazhdueshem kredia per Qeverine duke harmonizuar ne pergjithesi mire realizimin e shpenzimeve dhe te ardhurave te buxhetit. Po keshtu, ndikimet e liberalizimit te cmimeve te herepashershme u shmangen nga programi i kompensimit buxhetor qe ka

ardhur duke u permiresuar. Duke krahasuar rezultatet e arritura kete vit me kufijte e Programit kemi keto te dhena:

**Tabela 4.1 Realizimi i Kufijve te vendosur ne Program**

TREGUESIT	Dhjetor '92		Dhjetor ' 93	
	Programi	Realizimi	Programi	Realizimi

**Grafiku 4.2**




<b>Te ardhurat</b>	12500	13309	32100	32202
<b>Shpenzimet</b>	23200	21927	44400	43842
<b>Deficiti</b>	10700	8618	12300	11640

Ne shpenzimet buxhetore te ketij viti u vu theksi ne efikasitetin e tyre. Kete e shpreh edhe realizimi i investimeve ne masen 102.6 perqind qe tregon

pjesemarrjen me te madhe te buxhetit te shtetit ne ristrukturimin dhe zhvillimin ne fusha jetike si bujqesia, industria, transporti etj . Rritmi i rritjes eshte 2.6 here me i larte ne krahasim me realizimin e investimeve te vitit 1992 dhe keto jane financuar nga burimet e brendshme te buxhetit te shtetit. Efektiviteti i ketyre investimeve duket edhe ne hapjen e vendeve te reja te punes dhe punesimin ne to te forcave te lira. Nga 412 mije te papune ne fillim te vitit 1993, ne fund te ketij viti kemi 304 mije te papune. Per hapjen e vendeve te reja te punes krahas sektorit privat kontribut kane dhene edhe investimet e buxhetit.

Po keshtu nje mase te madhe te shpenzimeve ne vitin 1993 zune subvencionet per mbrojtjen sociale me 17 miliarde leke ose 38perqind te te gjithe shpenzimeve buxhetore. Procesit te ristrukturimit te ekonomise i ka sherbyer edhe fondi prej 1.6 miliarde leke i subvencionuar per ristrukturimin e ndermarrjeve dhe likuidimit te detyrimeve te tyre ndaj privateve. Vetem per interesat e borxhit te trasheguar buxheti ka paguar rreth 7perqind te te gjithe shpenzimeve buxhetore.



Grafiku 4.3

Megjithatë permiresimet e ndjeshme qe u vune re kete vit ne realizimin e te ardhurave efekti i reformes se taksave duhet permiresuar perseri.

Deficiti buxhetor eshte ulur nga viti ne vit. Nga 20.6 perqind e GDP qe ishte ne vitin 1991 ai u ul ne 17.4 perqind ne vitin 1992 dhe ne afro 10.4 perqind te GDP ne fund te 1993. Deficiti i vitit 1993 prej 11.6 miliarde lekesh eshte rreth 5.3 perqind me i ulet se kufiri i parashikuar ne Program. Borxhi i Qeverise ne fund te vitit 1993 eshte rreth 78.1 miliarde leke duke zene 69 perqind te GDP se parashikuar, nga i cili 31.6 miliarde leke eshte borxhi i brendshem dhe 46.5 miliarde leke eshte borxhi i jashtem.

Me krijimin e bankes se re qendrore dhe te ligjit te saj, Banka e Shqiperise reduktoi shume financimin e drejteperdrejte per buxhetin e shtetit. Ne

gjashtemujorin e dyte te 1992, Qeveria ushtroi nje kontroll te ashper mbi shpenzimet duke zbatuar nga ana tjeter nje politike efektive te te ardhurave. Mund te permendim taksat mbi te ardhurat, taksat doganore, akcizat etj.

Megjithese gjate vitit 1993, deficitit i buxhetit ishte nen kontroll dhe ne kufijte e tij, ai u mbulua teresisht me kredi nga ana e Bankes se Shqiperise. Ky perben nje burim te rendesishem, qe ka ushtruar ndikim te fuqishem ne treguesit e tjere ekonomike dhe financiare. Rritja e deficitit buxhetor, ka shkaktuar rritje te ofertes se parase dhe zvogelim te perqindjeve reale ne terma afatshkurter te interesit. Gjithashtu duhet permendur ndikimi ne kurset e kembimit dhe ne Bilancin e Pagesave, sepse zhvillimi ne perqindjet reale te kembimit varet nga kosto relative e zhvleresimit te monedhave dhe situata fiskale. Kjo ndikon ne menyre te drejteperdrejte ne pagat dhe ne cmimet dhe ne analize te fundit mund te thuhet se sa me te larta te jene pagat aq me shume ato influencojne mbi cmimet nepermjet politikës se te ardhurave.

Financimi total i deficitit buxhetor me kredi bankare nga Banka e Shqiperise edhe pse brenda kufijve te caktuar ne Program, ka cuar ne monetarizimin e ketij deficitit, duke qene burimi kryesor i rritjes se mases monetare dhe i shteses se emisionit. Kjo ka sjelle dukuri inflacioniste ne periudha afatmesme ose afatgjata. Politika e shtrenguar qe ka ushtruar dhe do te ushtroje Banka e Shqiperise edhe ne te ardhmen nuk eshte zgjidhje perfundimtare per kontrollin e situates monetare. Ne kete situatë nuk eshte e mundur te ekzekutohet nje politike monetare e pavarur pa perdorur mjetet e drejtperdrejte te kontrollit te mases monetare. Nje burim financimi i deficitit te buxhetit, sic dihet eshte edhe emetimi i letrave me vlere nga Qeveria. Tregu i letrave me vlere te qeverise do te mundesoje zbatimin e nje politike monetare me instrumenta indirekte. Krijimi i tregut te letrave me vlere eshte gjithashtu i rendesishem per zhvillimin e tregut te parase. Ai do te beje te mundur qe interesi te percaktohet nga tregu dhe do te lehtesoje krijimin e nje tregu nderbankar. Po punchet per percaktimin e struktures se letrave me vlere te emetuara, si dhe e portofoleve te tyre nga pikepamja e afatit te maturimit duke synuar emetimin e letrave me vlere afatgjata qe sigurojne nje likuiditet te larte dhe te qendrueshem.

Nga ana tjeter, ekzistenca e rrezikut ne procesin e investimeve, apo rreziku i ndryshimit te interesave reale orienton investimet ne emetimin dhe blerjen e letrave me vlere afatshkurtra qe jane Bonot e Thesarit dhe per te cilat eshte bere nje pune e konsiderueshme.

# KAPITULLI 5

## 1- BILANCI I PAGESAVE DHE POLITIKA E KURSEVE TE KEMBIMIT

Pas Luftes se Dyte Boterore dhe deri nga fundi i viteve 1970, partneret kryesore te Shqiperise ne tregtine e jashtme kane qene ish-vendet socialiste. Pas prishjes se marrredhenieve me B.S. ne 1961, Kina behet partneri kryesor dhe injekton ne Shqiperi kapitale te konsiderueshme, qe financojne deficite te medha te Bilancit te Pagesave gjate viteve 1960 - 1970. Pas 1978, marrredheniet e Shqiperise me vendet e tjera ndryshuan mjaft me zbatimin e politikës se mbeshtetjes ne forcat e veta dhe ndalimit te kredive te huaja.

Gjate dekades 1980 - 1990 tregtia orientohet drejt monedhave te konvertueshme. Deficiti korrent ne monedha te konvertueshme ishte i vogel dhe financohej nga pakesimi i rezervave te akumuluar gjate viteve 1970, nderkohe qe llogaria korrente ne monedha te pakonvertueshme ishte pak a shume e balancuar. Gjate kesaj periudhe bilanci tregtar ndihmohet edhe nga konjuktura nderkombetare dhe praktikisht Shqiperia nuk krijon borxhe.

Politika ekonomike e gabuar, e shoqeruar me thatesiren e ketyre viteve, problemet e prodhimit, teknologjia e prodhimit e tejet vjeteruar shkaktuan uljen e eksporteve dhe rritjen e importeve. Veshtiresohet mundesia e eksporteve madje edhe ne tregjet e Evropes Lindore.

Reformat politike e ekonomike te viteve 1990 - 1991 thelluan deficitin korrent ne monedha te konvertueshme duke reflektuar keshtu perkeqesimin e konjuktures, por dhe rritjen e theksuar ne volumin e importeve me monedha te konvertueshme. Deficiti i madh tregtar ne monedha te pakonvertueshme, ne vitin 1990, pasqyron nga njera ane ndryshime rrenjesore ne tregjet e eksportit te Evropes Lindore dhe nga ana tjetere, nje ndryshim ne drejtimin e eksporteve nga monedha te pakonvertueshme ne ato te konvertueshme si rrjedhoje e nevojës se ngutshme per valute. Deficitet ne bilancin e pergjithshem te pagesave financoheshin nga harxhimi pothuaj i plote i rezervave valutore, huamarrjet nga jashte, detyrimet e papaguara ne afat e huamarrjet nderbankare, si dhe moszbatimi i kontratave te Forex-it. Pra Shqiperia gjendet perpara nje borxhi te jashtem relativisht te madh e te veshtire per tu ristrukturuar, qe se bashku me ate ne monedha te pakonvertueshme ne qershor te vitit 1991 arrin ne rreth 500 milione USD (30 % te GDP).

Reformat e sektorit te jashtem u perqendruan kryesisht ne heqjen e kufizimeve legale per kredi dhe investime nga jashte dhe ne nje liberalizim te pjesshem te tregtise se jashtme dhe kembimeve valutore. Ne qershor te 1990 miratohen dekretet per mbrojtjen e investimeve te huaja dhe per ndermarrjet e perbashketa. Nenshkruhen marreveshje investimesh dypaleshe me vende te ndryshme. Krijohet Agjensia e Investimeve te Huaja per nxitjen e investimeve te huaja dhe shqyrtimin e propozimeve per to. Ne gusht 1990 hiqet monopoli i tregtise se jashtme pas vendimit per privatizimin. Liberalizohet eksport-importi me perjashtim te disa mallrave te licensuara dhe eksporteve te artikujve ushqimore te cilat mungonin shume ne treg. Qe nga viti 1991, gjithë tregtia e


jashtme dhe marreveshjet dypaleshe, zhvillohen ne dollare .Nuk ka me kurse kembimi te diferencuara per transaksione tregtare dhe jo tregtare.

Ne shtator 1991 zhvleresohet kursi i kembimit zyrtar duke u fiksuar me dollarin amerikan ne 25 leke/USD nga 10 leke/USD ne fillim te vitit 1991. Humbja e kontrollit mbi rezervat valutore dhe shterrimi pothuaj i plote i tyre shtrengoi autoritetet monetare ta zhvleresojne ne menyre administrative me tej lekun ne 50 leke/USD ne janar te vitit 1992. Gjate kesaj kohe vellimi i transaksioneve ne tregun paralel rritet se tepermi. Kursi i kembimit ne kete treg percaktohet nga forcat e tregut dhe shkon drejt zhvleresimit nga 40-43 leke/USD ne fillim te nentorit 1991, ne 78-81 leke/USD ne shkurt te vitit 1992. Ne korrik te vitit 1992, politika e kurseve te kembimit ndryshon. Fillon zbatimi i regjimit fleksibel te kurseve te kembimit dhe leku peson nje zhvleresim ne masen 220%, nga 50 ne 110 leke/USD. Fundi i vitit 1992 mbyllet me nje kurs kembimi 98.88 leke/USD.

Gjate vitit 1992 krijohet nje deficit korrent prej 405.6 milione USD, qe eshte 157 milione USD me i larte se ai vitit 1992. Por, nga ana tjetere, duket qarte se po frenohet shpejtesia me te cilen u krijuan deficitet e viteve paraardhese, nuk eshte rritur borxhi i jashtem, rezervat valutore te Sistemit Bankar jane rritur dhe pesha e sektorit privat ne transaksionet me "boten" ka nje ritem shume te larte rritjeje.


## **2- ZHVILLIMET NE BILANCIN E PAGESAVE GJATE VITIT 1993**

Bilanci i transaksioneve korrente gjate vitit 1993 shenoi nje suficit te lehte prej 9 milione USD. Ky suficit erdhi teresisht si rezultat i rritjes se transfertave korrente nga jashte dhe ne nje pjese te madhe, te atyre private (49.7 perqind).



Grafiku 5.2

Deficiti i transaksioneve tregtare gjate vitit 1993 kap shumen 490 milione USD. Ky deficit eshte 15 milione USD me i ulet se ai i vitit paraardhes. Duke kujtuar qe deficiti tregtar i vitit 1991 ishte 2.6 here me i larte se ai i vitit 1990 dhe ai i vitit 1992 1.6 here me i larte se ai i vitit 1991, deficiti tregtar i vitit 1993 ishte vetem 3 perqind me i vogel se ai paraardhes, qe tregon edhe nje here rritje te ekonomise.



Grafiku 5.3

Nderkohe qe deficiti i te ardhurave prej 11 milione USD erdhi duke u zvogeluar 3 here gjate periudhes, ne krahasim me 1992 nje thellim i metejshem u vu re ne deficitin e sherbimeve (79 milione USD) prej 30 milione USD ose 61 perqind. Keshtu, deficiti i larte ne sherbime e te ardhura, e thelloi deficitin tregtar afersisht me 1/5 e tij. Deficiti i llogarise korrente pa transfertat shteterore nga jashte per gjithe vitin 1993 rezultoi vetem sa 26 perqind e GDP, nderkohe qe Programi ekonomik afat-mesem per vitin 1996 percakton si objektiv nje deficit sa 10 perqind e GDP.

### ➔ Bilanci tregtar

Zhvillimi ekonomik i vitit 1993 shenoi nje zgjerim ne vellimin e tregtise se jashtme. Eksportet u rriten 60 perqind dhe importet 4.6 perqind. Rritja e eksportit perballoi shtesen e importit, duke ulur deficitin tregtar te vitit 1993 me 15 milione USD. Bilanci tregtar i ketij viti rregjistroi nje deficit prej 490 milione USD dhe duke perjashtuar ndihmat, deficiti arrin shifren 354 milione USD. Shqiperia nga deficiti i tregtise se jashtme qe ka krijuar gjate vitit '93, 72 perqind i ka perballuar vete kundrejt 20 perqind ne vitin 1992. Rritja ekonomike e vitit 1993 solli si pasoje uljen e raportit te deficitit tregtar me produktin e brendshem kombetar (GDP) ne 44 perqind, nderkohe qe ne vitin 1992 ky raport ishte 76.5 perqind. Rritja e prodhimit plotesoi me mire

mungesat e tregut dhe kerkesen e brendeshme, solli uljen e menjhereshme te importeve, dhe rritjen e shpejte te vellimit te eksporteve. Persa i perket sezonalitetit te tregtise se jashtme rritja e importeve prej 35 perqind ne gjashtemujorin e dyte, shkaktoi rritjen e deficitit tregtar ne masen 43 perqind kundrejt gjashtemujorit te pare.

## ➔ Eksporti

Zhvillimi ekonomik i vitit 1993 pasqyrohet ne rritjen prej 42 milione USD ose 60 perqind te eksporteve qe arriten ne 112 milione USD. Nga ecuria e tyre del se vetem eksportet e tremujorit te pare 1993 jane sa ato te gjashtemujorit te pare te vitit 1992 dhe arriten shifren me te larte te tyre 35 milione USD ne tremujorin e fundit. Viti 1993 shenoi nje ndryshim te rendesishem edhe ne strukturen e eksporteve. Verehet dominimi i eksporteve me origjine jo-bujqesore, te cilat zene 80 perqind te totalit ndryshe nga viti i kaluar ku ato perbenin 58.2 perqind. Ndryshimet strukturale dominojne edhe brenda ketij grupi mallrash ne favor te industrise se lehte me perpunimin e mallrave me lende te pare importi, te cilet perbejne 17.85 perqind te totalit te eksportit. Ne te kundert, nje renie te dukshme prej 22.1 perqind ne krahasim me 1992 pesuan eksportet e mineraleve, metaleve, energjise elektrike e lendes djegese.

**Tabela 5.1 Struktura e eksportit sipas grup-mallrave**

	(Ne mije leke) F.O.B.	
<b>EKSPORTI</b>	12,498,861	100.00%
<b>Minerale,kimikate,plastike..</b>	3,251,539	26.01%
<b>Kepuce, te tjera veshje kembesh</b>	2,230,648	17.85%
<b>Te tjera ushqimore, pije, duhan</b>	2,009,147	16.07%
<b>Prodhime te fabrikuara</b>	1,612,314	12.90%
<b>Artikuj tekstile</b>	1,258,919	10.07%
<b>Metalet dhe prod. e tyre</b>	713,729	5.71%
<b>Mish dhe produkte blegtorale</b>	365,431	2.92%
<b>Te tjera</b>	1,057,134	8.46%

Megjithese eksporti ne sasi i kromit u rrit, vlere e tyre ra me tej gjate vitit 1993 me 1 milione USD ne krahasim me vitin 1992 dhe 14 milione me pak se parashikimi i bere ne fillim te vitit. Ulja e cmimit te kromit ne tregun konkurrences per shkak te sasive te medha ne te dhe embargoja ndaj Serbise, jane arsyet me kryesore qe shkaktovan kete renie.

Eksportet e bakrit ishin rreth 5.1 milione USD eksporte, ose 2.8 milione USD me teper se ne vitin 1992 me nje rritje prej 250 perqind ne krahasim me ato te vitit paraardhes. Ulje te konsiderueshme ne krahasim me vitin 1992 ka pesuar eksporti i energjise (nga 24.4 perqind ne 4.1 perqind ose 9.4 milione USD me

pak). Ketu ka ndikuar, jo vetem ulja e cmimeve te importuesve te jashtem, por edhe shtimi i konsumit te energjise brenda vendit si rrjedhoje e investimeve ne sistemin energjistik.

Te dhenat tregojne per nje renie te eksporteve me origjine bujqesore gjate vitit 1993, prej 20.8 perqind ne krahasim me 1992, megjithese prodhimi bujqesor e blegtoral u rrit 14 perqind ndaj po ketij viti. Duhani dhe produktet e tij ruajne vendin kryesor ne keto eksporte me 32.2 perqind te vleres totale te ketyre grup-mallrave.

**Tabela 5.2 Struktura e eksportit sipas vend origjines**

		(Ne mije leke) F.O.B.
<b>EKSPORTI</b>	12,487,098	100.00%
<b>ITALI</b>	5,124,661	41.04%
<b>GREQI</b>	2,237,838	17.92%
<b>MAQEDONI</b>	1,397,058	11.19%
<b>BELGJIKE</b>	755,501	6.05%
<b>TE TJERA VENDE TE O.E.C.D.</b>	707,842	5.67%
<b>GJERMANI</b>	535,433	4.29%
<b>EUROPA LINDORE</b>	361,401	2.89%
<b>FRANCE</b>	219,975	1.76%
<b>TURQI</b>	169,775	1.36%
<b>ZVICER</b>	156,500	1.25%
<b>TE TJERA VENDE AZIATIKE</b>	368,207	2.59%
<b>TE TJERA VENDE</b>	452,907	3.63%

Ne realizimin e eksporteve gjate vitit 1993 partneret kryesore ashtu si edhe ne 1992 vazhduan te mbeten vendet e Komunitetit Evropian, si Italia (45.1perqind), Greqia (19.7perqind), Belgjika (6.6 perqind), Gjermania (4.7 perqind), Franca (2 perqind) etj, qe sebashku perbejne 80 perqind te tregut te eksporteve.

## ➡ Importi

Importi i mallrave, gjate vitit 1993, pesoi nje rritje prej 27 milione USD ose 4.7 perqind ne krahasim me vitin 1992. Megjithate, ritmet e rritjes se tij rane 5 perqind dhe shkak kryesor per kete ishte rritja ekonomike e pasqyruar ne rritjen e produktit te brendshem (GDP) me 11 perqind. Importet e financuara nga privatet gjate vitit 1993 perbenin rreth 50 perqind te totalit te tyre kundrejt 40 perqind ne vitin 1992.

Vlera e importeve pa perfshire ndihmat qe gjate vitit 1993 llogaritet ne 466 milione USD, duke shenuar nje renie te ndjeshme te importeve-ndihma (nga 348 milione USD ne 136 milione USD) prej 2.5 heresh krahasuar me vitin 1992. Duke klasifikuar importet sipas struktures vendin kryesor perseri e zene mallrat ushqimore dhe duhani me 26.5 perqind . Megjithe kete ritmet e importeve te mallrave ushqimore jane ulur 1.4 here ne krahasim me 1992, si rezultat i fillimit te funksionimit normal te sektorit te bujqesise. Gjate vitit 1993 importi i mallrave ushqimore zinte 26.5 perqind ndaj 43 perqind ne vitin 1992.

Ndarja e tokes ndikoi pozitivisht ne rritjen e prodhimit ne pergjithesi, ndersa ndryshimet ne strukturen e tij te orientuar nga prodhimi i dritherave (52 perqind te siperfaqes se mbjelle) coi ne pakesimin e importit te tyre, kryesisht te grurit i cili zinte vendin kryesor gjate vitit 1992.

Mjetet e transportit zhvendosen ne vend te dyte me 19.4 perqind te totalit. Makinerite dhe pajisjet si tregues te pakenaqshem te investimeve, kane pesuar nje renie te madhe gjate vitit 1993 duke zene 13.8 perqind ndaj 26.3 perqind ne vitin 1992. Importet ne metale e produkte te tyre perbejne 4 perqind te importeve. Importet per dege te ndryshme te industrise, ne masen 78 perqind u financuan nga burime te jashtme si ndihma e kredi dhe vetem 22 perqind e tyre paten si burim fonde te brendshme financiare. Vecoria me e rendesishme e tyre ka qene destinacioni i orientuar ne deget aktive te prodhimit per qellime te shfrytezimit sa me efektiv.

**Tabela 5.3 Struktura e importit sipas grup mallrave**

	(Ne mije leke) C.I.F.	
<b>IMPORTI</b>	60,893,315	100.00%
<b>Ushqime, pije, duhan</b>	16,086,761	26.42%
<b>Mjete transporti, traktore</b>	11,693,612	19.20%
<b>Makineri e pajisje</b>	9,925,855	16.30%
<b>Minerale,kimikate,plastike..</b>	8,236,159	13.53%
<b>Tekstilet dhe prod. e tyre</b>	4,296,386	7.06%
<b>Prodhime te fabrikua</b>	4,099,557	6.73%
<b>Metalet dhe prod. e tyre</b>	2,436,542	4.00%
<b>Te tjera</b>	4,118,443	6.76%

Pajisjet elektroshtepiake dhe materialet e ndertimit, te cilat jane pjese perberese e importeve private, regjistruan shifra te uleta gjate vitit 1993 dhe perbenin 6 perqind te tyre.

Zhvillimet ne ekonomine shqiptare treguan per nje orientim gjithnje e me te madh te zhvillimit te tregtise ne pergjithesi me vendet perendimore ku furnizues kryesor te saj jane vendet e Komunitetit Evropian (76.6 perqind te importeve). Italia,Greqia dhe Gjermania si vende me nje numer te madh

emigrantesh shqiptare zene dhe vendet kryesore ne sigurimin e importeve me perkatesisht 32.2 perqind, 17.8 perqind dhe 12.9 perqind te totalit te importeve. Lidhje te ngushta tregtare jane vendosur edhe me vendet fqinje si Bullgaria, Maqedonia me 8.6 perqind te totalit duke mos shkeputur lidhjet me vendet e Evropes Lindore nga te cilat jane siguruar 14.2 perqind e importeve.

**Tabela 5.4 Struktura e importit sipas vendit te origjines**

		(Ne mije leke) C.I.F.
<b>IMPORTI</b>	58,995,951	100.00%
<b>ITALI</b>	18,745,357	31.77%
<b>GREQI</b>	10,397,017	17.62%
<b>GJERMANI</b>	7,522,146	12.75%
<b>FRANCE</b>	5,092,876	8.63%
<b>BULLGARIA</b>	3,088,809	5.24%
<b>MAQEDONI</b>	1,954,974	3.31%
<b>TURQI</b>	1,776,129	3.01%
<b>SH.B.A</b>	1,772,178	3.00%
<b>BRITANI E MADHE</b>	1,534,049	2.60%
<b>TE TJERA VENDE TE EVROPES LINDORE</b>	774,988	1.31%
<b>BELGJIKE</b>	643,708	1.09%
<b>HUNGARI</b>	643,475	1.09%
<b>TE TJERA VENDE</b>	3,572,173	6.05%
<b>AUSTRI</b>	520,422	0.88%

### ➤ **Sherbimet dhe te ardhurat**

Deficiti i sherbimeve dhe te ardhurave prej 90 milione USD, qe perben 8.1 perqind te GDP, shenoi nje rritje te metejshme ndaj atij te vitit 1992 (84 milione USD).

Deficiti i sherbimeve pesoi nje rritje te dukshme ndaj vitit 1992 (49 milion USD) me nje vlere absolute 30 milione USD ose 61 perqind. Ky perkeqesim i dedikohet kryesisht sherbimeve te transportit qe e mbyllen vitin 1993 me nje deficit 45.7 milione USD qe perben 58 perqind te deficitit te sherbimeve dhe brenda tyre atij te mallrave 37.8. milione USD ose 83 perqind te tij. Deficiti i larte ne transportin e mallrave eshte rrjedhoje direkte e rritjes se importeve, qe ndikuan edhe ne thellimin e deficitit te sherbimeve te sigurimit.

Rritja e sherbimeve te pasagjereve kryesisht nga shoqeri e agjensi te huaja udhetimi solli nje zgjerim te metejshem te deficitit te te ketyre sherbimeve prej 2.5 heresh krahasuar me nje vit me pare.

Per shërbimet e komunikacionit, në muajin shkurt, rritja e tarifave të tyre mesatarisht 2.7 here ka sjelle një rënie të deficitit nga 9 milione USD në vitin 1992 në 4.8 milione USD gjatë këtij viti. Viti 1993 mbyllet me një suficit prej 52.2 milione USD ose afërsisht 5 here më i lartë se ai i vitit 1992, të zërit "Udhëtime" që pati një ndikim të rëndësishëm në lehtësimin e deficitit të shërbimeve. Rritja e numrit të vizitoreve të huaja 4 here krahasuar me vitin 1991 dhe 2 here krahasuar me vitin 1992 si dhe e koheqendrimit të tyre mesatar janë faktore kryesore të këtij rezultati.

Me një bilanc të lehtë pozitiv figurojnë edhe shërbimet qeveritare një pjesë të madhe të të cilave e zënë të ardhurat nga taksat. Në zvogelimin e deficitit të të ardhurave ndikuan se tepërmi të ardhurat nga puna të regjistruara nga emigracioni shtetëror që janë rritur 6.7 here në krahasim me vitin 1992 dhe të ardhurat nga interesat e institucioneve financiare që ishin 7.7 milione USD.

### ➤ **Transfertat e Njëanshme**

Flukse më të larta transfertash të njëanshme nga jashtë mbuluan deficitin në mallra, shërbime e të ardhura, dhe zhvendosjen llogarive korrente të 1993 nga deficioni 490 milione USD në një suficit të lehtë prej 9 milione USD. Ajo çka bie në sy të transfertat është ndryshimi i strukturës së tyre në favor të transfertave private (kryesisht nga emigrantet), madhësia e të cilave është rritur 95 përqind duke arritur në 293 milione USD. Struktura e tyre dominohet nga keshi që përbën rreth 90 përqind të këtyre transfertave, automjetet e përdorura dhe mallra të tjera. Nga ana tjetër, transfertat shtetërore janë tkurrur me 78 milione USD kundrejt vitit 1992. Duhet theksuar se transfertat shtetërore këtu vit përbën vetëm 27 përqind të GDP kundrejt 57 përqind një vit më parë. Ndihamat kanë patur edhe një ndikim tjetër indirekt në Bilancin e Pagesave, sepse duke u shitur për llogari të buxhetit kanë ulur deficitin buxhetor mbi 14 përqind, ka ndihmuar mjaft edhe në uljen e deficitit të llogarive korrente.

### ➤ **Importi i kapitaleve**

Importi i kapitalit i mëse 3 (3.2 here) fishuar gjatë vitit 1993, pozicionon ekonomine shqiptare si importuese neto kapitali dhe tregon prurje mjaft të mëdha investimesh të huaja, huamarrje shtetërore dhe kredi tregtare private më të larta. Investimet e huaja dhënë një hyrje kapitalesh prej 48 milione USD duke qenë burimi kryesor i sigurimit të tyre gjë që pasqyrohet në krijimin e shumë firmave e ndërmarrjeve të përbashkëta. Përveç investimeve në sektorin shtetëror u vu re një rritje në sektorin privat prej 32.3 përqind pas një rritjeje prej 12.5 përqind vitin e kaluar. Përsa i përket strukturës së investimeve, rreth 70 përqind e tyre janë në mallra dhe pjesa tjetër përbëhet nga importet në kesh dhe asistencë teknike.

Viti 1993 u karakterizua nga hyrje të larta të huave shtetërore nga jashtë, që në fund të vitit arritën shumën 67 milione USD nga 36 milione USD në vitin 1992. Ato u përdorën kryesisht si investime në bujqësi, ndërtim, rrjetin telefonik, etj. Huadhenesit kryesore të Shqipërisë janë Gjermania, Italia, Banka Botërore etj.

Komponenti tjetër i detyrimeve, në llogarinë financiare **"Monedhe e Depozita"** që jorezidentet kanë vendosur në bankat tregtare shqiptare, karakterizohet nga një rritje e tyre në tremujorin e dytë, që dominoi rënien në dy tremujoret e fundit duke arritur në fund të vitit 3.4 miliona USD .

Per t'u theksuar janë kapitalet e siguruara gjatë vitit 1993 nga **"Kredite tregtare"** të cilat nuk figuronin në bilancin e vitit 1992 dhe që regjistruan 10.8 miliona USD.

Investimet shqiptare jashtë dhe me hollësisht **"Depozita"** të bankave tona tregtare jashtë, që u karakterizuan nga dalje të larta të kapitalit në tremujorin e parë e të dytë, pesuan një zvogëlim të tyre gjatë tremujoreve të tjera. Kjo ndikoi në vlerën totale prej 45 miliona USD, e që megjithëkëtë tregon një rritje të tyre prej 22 miliona USD ose 51 përqind me shumë se në vitin 1992 (23 miliona USD). Ky import i konsiderueshëm u shoqërua paralelisht edhe me akumulim e eksportim mjetesh valutore.

### **3- ZHVILLIMET NE REZERVEN VALUTORE**

Suficiti i llogarise korrente dhe hyrjet e larta të kapitalit , kushtëzuan rritjen e rezervave të përdorshme valutore të autoriteteve monetare me 115 miliona USD, ndërkohë që në vitin 1990-1991 ato janë ulur qindra miliona USD dhe në vitin 1992 u rriten fare pak. Kjo rritje erdhi nga shtimi i depozitave "nostro". Niveli i rezervës së përdorshme në fund të vitit 1993 ishte i mjaftueshëm të përballonte rreth 14 javë importi nga 3 javë importi në fund të 1992. Politika e ndjekur nga Banka e Shqipërisë ka qenë ajo e akumulimit të rezervave dhe investimi i tyre me fitim maksimal, risk minimal e likuiditet të lartë. Në kuadrin e kesaj politike në shtator 1993, Bordi i Bankës së Shqipërisë miratoi politiken e administrimit të rezervës valutore në të cilën u përcaktua përberja e kesaj rezerve si dhe likuiditeti i nevojshëm për çdo ditë. Deri në këto periudha struktura e rezervave valutore dominohej nga depozitat në ECU (burim i së cilës ishin dy tranшет prej 35 miliona ECU dhënë nga Komuniteti Evropian për mbështetjen e bilancit të pagesave). Në këto kushte, rezerva valutore bazuar kryesisht në ECU përfitonte norma të larta të interesit, por mbetej i madh rreziku nga ndryshimet e papritura të kursit të këmbimit të ECU-së. Për këto arsye u përcaktua një përberje e re e rezervës valutore e cila do të shmangte në maksimum rrezikun e ndryshimit të kursit, duke pranuar investimin e fondeve në depozita me përqindje më të ulët të interesit, por me të qëndrueshme ndaj luhatjeve të kurseve të këmbimit. Levizjet e tregut në vijim konfirmuan në praktikë se politika e ndjekur ishte rezultative. Synimi i kesaj politike ka qenë krijimi i një rezerve valutore optimale si zbutese e krizave të ardhshme potenciale, për krijimin e lehtësive në tregti dhe në kredi, mundësimin e ruajtjes së konsumit korrent dhe së fundi rritjen e kredibilitetit të autoriteteve monetare në transaksionet financiare me jashtë. Për një ekonomi të hapur e me luhatje të mëdha në pagesat me jashtë, si kjo e jona, një politike e tillë ka qenë e domosdoshme. Një arsye më tepër për këto është dhe fakti që Shqipërisë i duhet të ristrukturojë një borxh të jashtëm jo të vogël. Në themel të kesaj politike rezervash qëndron edhe vendimi i autoriteteve monetare për

zbatimin e kursit fleksibel te kembimit si rregullues automatik i zbalancimeve ne sektorin e jashtem.

Nje ekuiliber i tille ne bilancin e pagesave, qe nenkupton zhvillime relativisht te favorshme ne pozicionin e jashtem, i krijon autoriteteve monetare te vendit mundesine per te ngushtuar fokusin gjithmone e me teper ne politikat e ristrukturimit te brendshem ekonomik.

#### **4- ZHVILLIMET NE TREGUN E KEMBIMEVE VALUTORE**

Aktiviteti ekonomik ne rritje dhe politikat makroekonomike rezultative te vitit 1993 sollen stabilitet ne vleren e lekut dhe ne pergjithesi ne kembimet valutore. Shifrat e vitit 1993 tregojne qe kursi i kembimit ka qene nje rezultante e luhatjeve ne hyrjet e valutes nga emigracioni, ecurise se importeve dhe menyres se tyre te financimit, zhvillimeve monetare nen kontroll si dhe deficitit buxhetor etj. Rritja me e shpejte e ofertes se valutes ne fillim te vitit ndaj rritjes se kerkeses per valute nga importet percaktoi nje prirje te forcimit te lekut, nderkohe qe renia me e shpejte e ketyre hyrjeve ne fund te vitit se sa renia e kerkeses per valute nga importet e shtyu lekun drejt zhvleresimit. Duhet se ne kerkesen e valutes per import ka ndikuar mjaft dhe financimi sekondar i importeve nga ndihmat, kredite tregtare dhe mallrat nga emigracioni.

Duke u ndalur ne ecurine e kursit te kembimit, dollari amerikan kursin me te larte e arriti ne Shkurt me 106.583 leke/USD dhe pas kesaj ka pasur vazhdimisht nje prirje uljeje duke sjelle nje vleresim te vazhdueshem te lekut. Kursi i kembimit me i ulet eshte evidentuar ne Nentor me 96.44 leke /USD. Vihet re se luhatjet e kursit te kembimit te valutave te ndryshme me lekun ne banke jane te shumta dhe te shtrira gjate te gjithë vitit duke krijuar pershtypjen e nje levizjeje te vazhdueshme lart e poshte ne krahasim me tregun paralel, ku vihët re nje prirje e percaktuar mire. Keto luhatje kane ardhur sepse bankat tregtare kane realizuar transaksione te njeanshme, blerjet i kane kaluar dukshem shitjet ose anasjellas, hapësira ndermjet shitjes dhe blerjes ka qene mjaft e madhe dhe kursi mesatar shprehte vetem ekstremet e tij. Keshtu, kursi mesatar ditor i largohej mjaft kursit mesatar real te tregut. Ka nje diference te vazhdueshme ndermjet kurseve te bankes dhe te tregut te lire. Kjo diference shpjegohet me prirjen e bankave tregtare per blerjen e valutes nga subjekte shteterore duke perfituar kurse me te ulta per bankat se sa ato ne tregun paralel. Kjo prirje i coi bankat ne krijimin e pozicioneve te hapura ne valute ne shuma te konsiderueshme ne mesin e vitit 1993, gje qe solli edhe mungesen e theksuar te likuiditeteve. Zgjdhja u gjet ne shitjen e valutes se akumuluar subjekteve financiare dhe jofinanciare qe solli ne kete kohe nje zhvleresim te dollarit dhe nje ngushtim te madh ndermjet kuotimeve ne banke dhe ne treg (shih grafiket 5.5 - 5.8).

Tregu i kembimeve valutore ne Shqiperi nuk ka funksionuar efektivisht sepse sherbimi i ofruar nga bankat e nivelit te dyte ishte shume i kufizuar, mungesa e sherbimit ne Forex perbente nje pengese serioze per zhvillimin e investimeve dhe biznesit ne Shqiperi. Deri tani Banka e Shqiperise nuk kishte

gjetur menyren per te nderhyre ne tregun paralel pasi ky punonte vetem me kesh. Licensimi i kembimeve valutore beri te mundur qe te merrej informacioni i nevojshem per transaksionet qe kryheshin ne kete treg. Per te pershpejtuar rolin aktiv te saj ne zhvillimin e ketij tregu, Banka e Shqiperise inkurajoi hapjen e zyrave te kembimeve valutore. Ne kete kuader u punua per hapjen e zyres se rregullimit te kembimeve me zyrat e kembimeve jashte bankes per te krijuar kushte per blerjen dhe shitjen e valutes kesh ne tregun paralel. Kjo gje do te ndihmoje ne perkryerjen e mekanizmave te nderhyrjes se Bankes se Shqiperise ne tregun e kembimeve valutore, ne zhvillimin e tregut nderbankar si dhe ne stimulimin e pjesemarrjes se bankave te nivelit te dyte ne kete treg. Ne kete kuader, Banka e Shqiperise po pergatitet qe te veproje me kalime ne llogari ne favor te zyrave te kembimit krahas veprimeve ne kesh. Ajo, gjithashtu, do te autorizojte zyrat e kembimit per te importuar ose eksportuar bankenota nepermjet llogarive te tyre. Po ne kete menyre, u punua per heqjen e kufizimeve per veprimet ne transaksionet korrente si dhe mundesine e heqjes se ketyre kufizimeve ne llogarite e kapitaleve, si dhe per pershtatjen e rregullave per trasnferimin e kapitaleve ne mbeshtetje te ligjit te ri "Per investimet e huaja". Kursi i kembimit qe do te zbatohet per transaksionet bankare do te jete kursi i tregut dhe jo kursi mesatar i dites se veprimit.

# KAPITULLI 6

## 1- PLANI FINANCIAR I BANKES SE SHQIPERISE

Per vitin ushtrimor financiar 1993, Banka e Shqiperise pati rreth 2.5 miliarde leke te ardhura dhe shpenzime rreth 1.09 miliarde leke, duke siguruar nje fitim neto prej rreth 1.45 miliarde leke. Sic shihet per cdo lek shpenzim pati rreth 1.33 leke fitim neto.

Ne strukturen e te ardhurave rreth 87 perqind e zene te ardhurat nga interesat e mara nga bankat e vendit, institucionet dhe Qeveria, rreth 1 perqind dividendi per pjesmarrjen ne kapital dhe me pak se 1 perqind te ardhura te tjera.

Ne te ardhurat nga interesat peshen kryesore e zene interesat e mara nga Qeveria per kredine neto te dhene gjate vitit 1993, dhe per tepricen e kredise neto gjate 6-mujorit te dyte te vitit 1992. Te ardhurat e marra nga Qeveria per interesa, zene 44 perqind te totalit ndaj ketij grupi te ardhurash ose 38 perqind ndaj totalit te te ardhurave te vitit 1993.

Rritja e rezerves valutore dhe depozitimi i saj ka dhene rreth 604 milione leke ose 27 perqind te te ardhurave nga interesat. Nje pjese me te vogel se 6 perqind e ketij grupi te ardhurash jane nga rifinancimi i bankave te nivelit te dyte gjate vitit 1993.

Pjesen me te madhe ne shpenzimet e vitit 1993, e zene shpenzimet per interesat pasive, sidomos ato te paguara per mbi rezervat, me 76 perqind te totalit te shpenzimeve gjithsej. Shpenzimet operative zune vetem 6 perqind te shpenzimeve totale. Transferimi i amortizimit te ndertesave, pajisjeve, mjeteve te transportit si dhe bankenotave e monedhave ze rreth 15 perqind te shpenzimeve totale ose rreth 165 milione leke.

Nje rendesi te vecante mori edhe hartimi i nje plani financiar te detajuar per vitin ushtrimor 1994. Ne perputhje me kushtet aktuale Buxheti i Bankes se Shqiperise per 1994 eshte hartuar i ndare ne dy pjese kryesore:

1. Buxheti i Investimeve
2. Buxheti per Shpenzimet Operative.

Ne lidhje me pjesen e pare jane mbajtur parasysh keto aspekte kryesore:

- a) Sigurimi i Bankes se Shqiperise ;
- b) Pershtatshmeria e ambienteve per nje Banke Qendrore te afte per te kryer operatione moderne ;
- c) Forcimi i besimit publik.

Eshte menduar qe shuma totale e buxhetit te investimeve te jete rreth 517 milione leke, ku pjesen kryesore do ta zene: shtypja e kartemonedhave rreth

230 milione leke; ndertimi i apartamenteve per punonjesit rreth 130 milione leke; rinovimi i ambienteve te punes rreth 60 milione leke etj.

Ne buxhetin operativ do te kape nje shume relativisht modeste, rreth 123 milione leke :

- rritja e nivelit te pagave dhe e numrit te personelit te Bankes se Shqiperise ;
- inflacioni, rritja e cmimeve te sherbimeve publike dhe te mallrave te ndryshme;
- mbajtja me e mire e aktiveve te Bankes se Shqiperise.

Gjithashtu ne totalin e shpenzimeve per vitin 1994, nje pjese te rendesishme do te zene shpenzimet per interesa pasive. Me konkretisht eshte parashikuar t'i paguhen rreth 1.4 miliarde leke Bankes se Kursimeve per depozitat e saj prane Bankes se Shqiperise. Gjithashtu jane parashikuar transferime te amortizimit te pajisjeve, zyrave dhe bankenotave ne vitin ushtrimor financiar 1994 per rreth 238 milione leke.

Te ardhurat eshte parashikuar te kapin shumen 4.04 miliarde leke ose 59 perqind me shume se ato te vitit 1993. Peshen kryesore perseri do te zene interesat aktive nga kredia neto per Qeverine dhe interesat aktive nga rifinancimi i bankave te nivelit te dyte perkatesisht ne masen 2.5 miliarde leke dhe 730 milione leke. Interesat per depozitat ne bankat e huaja do te kapin shumen 530 milione leke.

Nga sa me siper, parashikohet qe ne fund te vitit ushtrimor financiar 1994, te sigurohet nje fitim prej 2.24 miliarde lekesh i cili do te ndahet ne perputhje me normat e caktuara ne Ligjin "Mbi Banken e Shqiperise". Mbi bazen e treguesve te mesiperem pritet qe fitimi neto per cdo 1 lek shpenzim te jete 1.24 leke.

## **2- REFORMA PËR RISTRUKTURIMIN E SISTEMIT BANKAR**

Dihet qe deri me fillimin e Reformes ekonomike, e cila do te conte Shqiperine ne rrugen e nje vendi me ekonomi tregu, sistemi financiar i vendit ishte i pazhvilluar dhe i papergatitur per te vepruar ne kushtet e nje ekonomie te tille. Po ashtu eshte e kuptueshme se Reforma ekonomike nuk do te mund te zhvillohej me sukses pa nje Sistem Bankar modern te afte per te vepruar ne kushtet e reja. Reforma ne Sistemin Bankar filloi ne prill 1992 me miratimin e dy ligjeve per te, duke miratuar strukturen e sotme me dy nivele: Banke Qendrore (Banka e Shqiperise) dhe banka te nivelit te dyte (Bankat Tregtare) dhe bazen ligjore te tij; krijuan premisa per nje Banke Qendrore te pavarur etj..Krijimi i Bankes se Shqiperise ne ate kohe ishte vetem faza e pare e kesaj reforme. Perpjekjet e metejshme gjate kesaj periudhe u perqendruan ne zhvillimin e aftesise institucionale te Bankes se Shqiperise per zbatimin dhe drejtimin e politikave te parase dhe kreditit, ne drejtimin e veprimeve te kembimeve valutore dhe te rezervave te perdorshme , mbikqyrjen bankare si

dhe sigurimin e nje sistemi te afte pagesash per t'i sherbyer te gjithe Sistemit Bankar.

Pas hapave te pare ne kete strukturim Banka e Shqiperise po ballafaqohet menjehere me probleme qe lidhen pazgjithshmerisht me ristrukturimin e metejshem te Sistemit Bankar.

### ① **Fuqizimi i bankave ekzistuese**

*Rikapitalizimi.* Ky problem ka te beje me pastrimin e huave te keqia te ndermarrjeve shteterore nga librat e bankes dhe instruktimin e tyre qe atone te ardhmen te kreditojne vetem mbi baze tregtare. Per kete qellim ne fund te vitit 1992 Qeveria pranoi t'u falte ndermarrjeve shteterore borxhin qe ato kishin trasheguar para vitit 1992. Kjo nenkupton emetimin e obligacioneve nga ana e Ministrise se Financave per te zevendesuar 4.3 miliarde leke te shumes se kredive pa shprese arketimi te Bankes Kombetare Tregtare (BKT), te krijuara para korrikut 1992, nga ndermarrjet shteterore. Ky veprim do te kryhet vetem mbas revizionimit te llogarive te BKT ne 1994 dhe si nje pjese e strategjise se privatizimit do te bihet dakord me Banken Boterore.

*Pastrimi i marredhenieve nderbankare.* Ne te do te perfshihen te gjitha bankat shteterore dhe te perbashketa qe ne 31 Dhjetor 1993 rezultojne me aktivitet ne Shqiperi, me ose pa license. Pastrimi i gjithe llogarive do te kryhet jo me vone se 30 Qershori 1994. Banka e Shqiperise eshte pergjegjese per nxjerrjen e nje dokumenti ku njoftohet pastrimi i gjithe detyrimeve te prapambetura nderbankare.

Pastrimi i detyrimeve te prapambetura do te perfshije gjithe transaksionet e lidhura me Banken e Shqiperise, qofte si huamarrese, qofte si huadhenese, qe rezultojne ne 31 Dhjetor 1993. Pastrimi i ketyre llogarive do te kryhet jo me vone se 30 Qershori 1994. Pastrimi i detyrimeve te prapambetura nderbankare do te perfshije investimet kapitale te Bankes se Shqiperise ne bankat e tjera shteterore. Shlyerja e ketyre investimeve do te kryhet jo me vone se 31 Dhjetori 1994.

Pozicionet nderbankare do te debitoohen e kreditohen nepermjet llogarive te mbajtura ne Banken e Shqiperise. Pozicionet neto me suficit do te kapitalizohen ne formen e parase kesh, bonove te Thesarit, ose te letrave te tjera likuide te Qeverise.

Ne lidhje me *kreditin* do te organizohet programi i edukimit publik mbi nenkuptimin ligjor te praktikave te huamarreses dhe te huadhenies me qellim venien e theksit ne ndryshimin e pergjegjesive te klientit dhe bankes ne kushtet e zbatimit te reformes ne sektorin financiar.

Qellimi kryesor i ketij programi eshte nxitja e te kuptuarit publik te nevojës se drejtimit te kujdeshem te burimeve te kreditit nga kendveshtrimi i huamarresit dhe i huadhenesit, per te siguruar nje sektor bankar stabel, ne rritje dhe te ndjeshem kundrejt nevojave te nje ekonomie tregu ne rritje. Programi i edukimit publik do te theksoje rendesine e permbushjes se gjithe kerkesave

per sherbimin e kredise ne kohen e caktuar si dhe rendesine e nderthurjes ligjore ne rastet e moskthimit ne kohe te kredise.

Huamarresit do te informohen me ndryshimet ligjore lidhur me vendosjen e kolateraleve dhe te drejtat e pronesise per sa u perket detyrimeve te klienteve kundrejt bankave. Bankat do te informohen per rendesine e vleresimit te standarteve per huadhenie te matura si edhe per kohen dhe koston ne para te rikthimit te mjeteve per te mbuluar sherbimet ndaj klienteve.

Gjithashtu, programi i edukimit publik do te theksoje ndryshimin e rolit te Bankes se Shqiperise. Huamarresit dhe huadhenesit do te informohen se Banka e Shqiperise nuk do te pranoje pergjegjesine per lidhjet midis bankave dhe huamarresve, bile as do te veproje ne emer te tyre. Roli i Bankes se Shqiperise do te kufizohet ne vendosjen e politikës duke paraqitur legjislacionin dhe duke forcuar rregullat perkatese.

## ② **Krijimi i institucioneve te reja private**

Eshte krejt normale qe edhe te ne procesi i kalimit ne ekonomine e tregut te shoqerohet me zgjerimin e sistemit bankar. Kontributi i bankave ne zhvillimin e ekonomise eshte i madh dhe ky arrihet me veprimtari konkrete e moderne te bankave te qendrueshme.

Ketu mbeshtetet edhe politika e Bankes se Shqiperise ne ushtrimin e kompetences qe i jep ligja per t'u dhene licence veprimtarie bankave te nivelit te dyte. Kjo procedure gjen mbeshtetjen e vet ne miratimin e rregullave te reja te cilat krijojne mjaft hapësire per shtimin e Sistemit Bankar me banka te reja tregtare.

Ne te njejten kohe, nepermjet kerkesave te percaktuara per nivelin e kapitalit, personalitetin dhe pervojen ne veprimtarine bankare, garancite per nje biznes te besueshem etj., eshte pasur parasysh, minimizimi i mundesive per paqendrueshmeri dhe per ndonje falimentim te mundshem te ndonje banke. Synimi yne eshte qe me nje politike seleksionuese dhe me nje mbikqyrje efektive, te ruhet dhe te rritet besueshmeria e publikut ne aftesine e sistemit bankar ne pergjithesi.

Me qellim garantimin e qendrueshmerise te sistemit bankar ne Shqiperi, Banka e Shqiperise ka vendosur normat minimale te kapitalit qe duhet te kete secila banke ndaj nivelit te mundshem te rreziqeve te saj. Me konkretisht per bankat me kapital shteteror, per bankat e perbashketa me kapital te shtetit shiptar dhe me kapital te huaj si dhe per bankat e huaja qe u perkasin vendeve te OECD-se, norma e mjaftueshmerise se kapitalit eshte caktuar jo me pak se 8 perqind. Ndersa per te gjithë bankat e tjera, jo me pak se 15 perqind.

## ③ **Permirosimet ne infrastrukturen bankare**

*Ne Kontabilitet*, per bankat prone shteterore, mbetet detyre paresore zhvillimi i qartesimit te llogarive.

*Ne Mbikqyrjen e bankes*, ne kete moment celsi i prioriteteve perfshin rritjen e personelit te departamentit te mbikqyrjes, trainimin e tyre dhe trajtimin e rregullimeve te mbetura te paperfunduara qe rrjedhin nga Ligji per Sistemin Bankar. Ne vazhdim me zhvillimin e metejshem te Sistemit Bankar dhe me hapjen e bankave private do te merren masa te shpejta per fuqizimin e mbikqyrjes, qofte duke kerkuar asistencë te huaj per te permiresuar funksionet e mbikqyrjes.

*Ne Sistemin e Pagesave*, detyre kryesore mbetet perfundimi i punes se filluar, duke perfshire kalimin e projekt amendamenteve te Ligjit mbi Cekun, te projektit mbi Bonot e Thesarit, zbatimi i tyre dhe me kryesore mbetet padyshim sistemi korier.

*Ne Training* prioriteti eshte ne fuqizimin e metejshem te Qendres se Trainingut dhe krijimi i programeve trainuese te institucionalizuara.

Persa i perket *Kornizes Ligjore*, do te punohet per nje rishikim, me qellim gjetjen e hapesirave dhe pikave te paqendrueshme ne kornizen ligjore, si dhe per percaktimin e prioriteteve ne te ardhmen. Prioritet kryesor do te jene statusi ligjor dhe pronesia mbi entitetet, pasurite dhe aktivitetet e bankave, etj.

### **3- MARDHENIET ME INSTITUCIONET FINANCIARE NDERKOMBETARE**

Banka e Shqiperise qe ne fillim te aktivitetit te saj ka krijuar marredhenie ose ka zhvilluar me tej marredheniet e meparshme me institucionet e ndryshme financiare nderkombetare. Keto marredhenie njohen zhvillime te reja pas vitit 1991, kur Shqiperia behet anetare e FMN dhe Bankes Boterore. Keto organizma i japin perkrahje te plote Reformes Ekonomike te ndermarre ne vendin tone. Keshtu me FMN arrihet ne programin mbeshtetes Stand-By, qe fillon te zbatohet ne vitin 1992 dhe vazhdoi pastaj me Programin afatmesem ekonomik ESAF(1993-1996), qe filloi te zbatohet ne gusht te vitit 1993. Kredia Stand- By ishte 20 milione SDR , kurse huaja per Programin ESAF ishte 42.36 milione SDR.

Me Banken Boterore, eshte punuar kryesisht per ristrukturimin e Sistemit Bankar ne Shqiperi ne drejtim te licensimit te bankave private, te fuqizimit te bankave ekzistuese shtetere , per privatizimin e tyre etj.

Nga Komuniteti Evropian, gjate muajit Gusht 1993 na u akordua *tranch-i* i dyte prej 35 milione ECU ne mbeshtetje te Bilancit te Pagesave dhe per forcimin e rezervave te vendit.

Per vitin 1993, Banka e Shqiperise eshte mbeshtetur kryesisht nga Bankat Qendrore te Austrise , Italise, Frances, Gjermanise si edhe *Federal Reserve Bank of Boston*, mbeshtetje e cila ka konsistuar kryesisht ne hartimin dhe venien ne zbatim te projekteve te ndryshme si dhe marrjen persiper te kualifikimit afatshkurter te punonjesve te bankes sone si edhe ne asistencë teknike ofruar nga keto banka ne sektore te ndryshem si per krijimin e *clearing house*, per ceqet, informatizimin,etj.

#### **4- OBJEKTIVAT E POLITIKES MONETARE PËR VITIN 1994**

Pas mbylljes me sukses te programit "Stand-By" me FMN dhe arritjeve te fundit, vendi eshte angazhuar ne nje program afatmesem rregullimi makroekonomik dhe strukturor qe shtrihet ne periudhen kohore 1993-96. Qellimi kryesor i ketij programi, te filluar pothuajse nje vit me pare, eshte ruajtja e rritjes se prodhimit, ulja e metejshme e nivelit te inflacionit dhe permiresimi i deficitit te Bilancit te Pagesave.

Politika monetare mbetet elementi kryesor per arritjen e suksesit, e mbeshetur kjo edhe nga politika e te ardhurave. Realizimi i uljes graduale te rritjes se mases monetare, sikurse parashikon programi, i kordinuar me kalimin gradual nga nje buxhet me deficit te konsiderueshem ne nje suficit modest ne fund te 1996 synon ruajtjen dhe konsolidimin e stabilitetit monetar, rritjen e investimeve publike ne infrastrukture dhe ne permiresimin e pozicionit te Bilancit te Pagesave. Pjese te kesaj strategjie komplekse jane dhe objektivat per vitin 1994, vit ne te cilin parashikohet nje rritje reale e GDP per rreth 8 perqind, ulje e ndjeshme e inflacionit ne 24 perqind ne fund te vitit 1994 dhe rritje e rezervave te perdorshme per rreth 40 milione USD. Strategjia per objektivat kryesore te programit ekonomik dhe atij monetar ne vecanti bazohet ne zhvillimin e metejshem te sektorit privat, rritjen e metejshme te te ardhurave dhe te investimeve, vendosjen e limiteve te pershtatshme per rritjen e kredise etj.

Parashikimi ne programin ekonomik dhe monetar i rritjes se metejshme te kursimeve kombetare do te beje te mundur rritjen e investimeve kombetare, nga 14 perqind te GDP ne vitin 1993, ne 16 perqind te GDP ne vitin 1994.

Duke u nisur nga situata monetare e periudhes se kaluar si dhe nga ulja e ndjeshme e inflacionit shihet qarte se mbarevajtja e kesaj strategjie kerkon vazhdimin e nje politike monetare te shtrenguar. Per kete, Banka e Shqiperise synon te kufizojë rritjen e mases monetare gjate vitit 1994 ne 29 perqind, duke reflektuar objektivat per rritjen nominale te GDP dhe nje rritje modeste te kerkeses per para qe pritet si rezultat i uljes se shpejtesise se qarkullimit te tyre prej 5 perqind. Mbi baze te situatave dhe mangesive te verejtura, Banka e Shqiperise synon kufizimin e Mjeteve te Brendshme Neto te Sistemit Bankar jo me teper se 36 perqind te mases monetare. Krediti per Qeverine per mbulimin pjesor te deficitit buxhetor parashikohet te kufizohet ne jo me shume se 26 perqind te mases monetare apo rreth 8 perqind te GDP.

Perqindja e interesit per vitin 1994 synohet te mbahet ne nivele pozitive reale deri sa te krijohen kushtet qe perqindjet e interesit te percaktohen lirisht nga tregu. Banka e Shqiperise cdo tremujor do te rishikojë nivelin e interesave per depozitat, duke i rregulluar ato ne varesi te gjendjes monetare. Keshtu ne janar te vitit 1994, Banka e Shqiperise ndryshoi perqindjet e interesit per depozitat duke ndikuar ne nivelin e kreditit, koston e buxhetit te shtetit dhe investimet ne ekonomi.

Banka e Shqiperise po punon intensivisht per zbatimin ne praktike te dy projekteve te rendesishme. Keshtu, para fundit te 6-mujorit te pare te 1994,

Banka e Shqiperise do te filloje sistemin e kleringut per marredheniet nderbankare, duke futur cekun ne sistemin pagesave, si dhe po punon per venien ne zbatim te sistemit te sherbimit korrier per sistemin bankar. Ky sherbim qe parashikohet te filloje ne Korrik te ketij viti do te ndikojte ndjeshem ne rritjen e cilesise se sherbimit bankar dhe efektivitetin e sistemit te pagesave. Gjithashtu, Banka e Shqiperise brenda 6-mujorit te pare do te organizoje tregun e letrave me vlere, duke tregtuar fillimisht bono thesari e me pas certifikata depozitash dhe obligacione shteterore.

Nderkohe, qe edhe per nje periudhe te shkurter kohe, politika monetare do te vazhdoje te bazohet te kufijte e kreditit, Banka e Shqiperise po punon per fuqizimin e teknikave dhe te instrumentave per te matur dhe per te kontrolluar oferten e bazes monetare. Deri me sot, Banka e Shqiperise ka nje kontroll te kufizuar mbi kete tregues, per vete faktin se Qeveria nuk ka menyre tjeter per financimin e brendshem te deficitit buxhetor vecse nepermjet marrjes hua nga Banka e Shqiperise. Kjo situatë, se bashku me sistemin e rfinansimit po ndryshon me shpejtesi. Banka e Shqiperise ka pergatitur rregulla te reja mbi rfinansimin dhe riskontimin, gjithashtu Qeveria se shpejti do te filloje emetimin e bonove te thesarit nepermjet Bankes se Shqiperise, veprim i cili do te lejojte financimin e nje pjese te deficit buxhetor ne treg, dhe jo 100 perqind nga Banka e Shqiperise. Pas ketyre ndryshimeve Banka e Shqiperise do te jete ne gjendje te percaktojte masen e bazes monetare qe do t'i ofrohet ekonomise nepermjet nderhyrjes me ane te instrumentave te caktuar.

Gjithashtu, po punohet edhe ne projektin per zhvillimin e tregut te kembimeve valutore. Kjo do te ndihmoje ne krijimin e mekanizmave te nderhyrjes se Bankes se Shqiperise ne tregun e brendshem te kembimeve valutore, stimulimin e bankave te nivelit te dyte per pjesemarrjen ne kete treg. Zyrtat e kembimeve valutore do te veprojne me kesh ose me llogari duke perdorur llogarite prane Bankes se Shqiperise ose prane bankave te nivelit te dyte.

Per percaktimin sa me real te te ardhurave te Bankes se Shqiperise mbeshtetemi ne zhvillimet monetare aktuale, parashikimet monetare si dhe programimet perkatese.

Per vitin 1994 parashikohen rreth 4.045 miliarde leke te ardhura ose 59 perqind me te medha se ato te realizuara gjate vitit 1993. Ne kete realizim perseri peshen kryesore do ta kene faktoret qe permendem. Interesat aktive nga kredia per Qeverine parashikohen te rriten nga 974 milione leke ne vitin 1993 ne 2.5 miliarde leke ne vitin 1994. Ndikim pozitiv do te kete ritja e teprices si baze per njehsimin e interesave, kurse ndikim negativ sjell parashikimi i interesave me te ulta per vitin 1994 si rezultat i uljes se inflacioit.

Te ardhurat nga interesat per rfinansim nga Banka e Shqiperise parashikohet te arrijne rreth 730 milione leke. Burim kryesor i ketyre mendohet te jete rfinansimi per Banken Kombetare Tregtare. Interesat aktive ne valute mendohet te jene rreth 510 milione leke.

Per vitin 1994 parashikohen rreth 4 045 milione leke te ardhura dhe rreth 1801 milione leke shpenzime d.m th. nje fitim neto prej 2 243 milione leke.

Politika monetare është elementi me kryesor për sigurimin e një stabiliteti makroekonomik që në fillim të reformës së tranzicionit. Në rast se që në këtë moment nuk do të ketë stabilitet monetar, ku inflacioni të ulët ndjeshëm, papunësia të mbahet në nivele të pranueshme, Bilanci i Pagesave të fillojë të përmirësohet dhe monedha kombëtare të krijojë besim tek ata që e mbajnë atë, atëherë suksesi i reformës ekonomike, kalimi drejt një ekonomie tregu do të jetë i vështirë, pavarësia e Bankës Qendrore do të cenohet dhe situata sociale mund të acarohet.

Politika monetare jep mundësi të shpejta, por të perkohshme për arritjen e objektivave kryesore si punësim më të madh, financim të deficitit buxhetor, përmirësim të Bilancit të Pagesave dhe nivel të ulët interesash.

Banka e Shqipërisë është përfshirë tërësisht në procesin e ristrukturimit dhe reformës në Sistemin Bankar. Krijimi i sistemit të garantimit të depozitave, përmirësimi i treguesve financiarë e monetarë të bankave të nivelit të dytë dhe privatizimi i tyre janë procese që po ndiqen me vëmendje. Ajo do të punojë për përmirësimin e mëtejshëm të kuadrit ligjor dhe rregullues të saj dhe të bankave të nivelit të dytë. Parashikohen të bëhen ndryshime në të dy ligjet "Për Bankën e Shqipërisë" dhe "Për Sistemin Bankar në Shqipëri". Kjo do të ndikojë në rritjen e besimit në politiken monetare dhe pavarësinë e Bankës së Shqipërisë. Ajo do të ndikojë në një harmonizim më të mirë ndërmjet pavarësisë ligjore dhe asaj praktike.